



**Universiteti i Elbasanit  
“Aleksandër Xhuvani”  
FAKULTETI EKONOMIK**

**PUNIM DIPLOME**

**PUNIM DIPLOME  
PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE  
MASTER I SHKENCAVE NË EKONOMIA DHE E DREJTA NË TREGJET  
NDËRKOMBËTARE**

**Tema: Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe integrimi i Shqipërisë në  
BE.**

**PUNOI:**

**Sara KUQANI**

**UDHËHEQËS:**

**Prof. Asoc. Dr. Arbër GJETA**

**ELBASAN, SHTATOR 2023**

## **Abstrakt**

Procesi i integritit i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është konsideruar si prioriteti më strategjik kombëtar, i cili udhëheq axhendën qeverisëse të vendit. Që nga qershori i vitit 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për në BE. Megjithatë kriteret e vendosura nga Bashkimi Evropian për anëtarësim janë parakushte për kalimin e fazës tjetër të procesit, i cili është ai i hapjes së negociatave. Gjatë këtij punimi diplome kam trajtuar ecurinë e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Në kapitullin e dytë kam trajtuar çështjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe integritit Evropian. Në kapitullin e tretë kam marrë në shqyrtim kronologjinë e marrëdhënieve të vendit tonë me BE-në. Në kapitullin e katërt kam folur për Përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis-in* e BE-së.

Zgjedha këtë temë për të mbrojtur diplomën, sepse është një temë bashkohore ku të gjithë shqiptarët janë të interesuar tek ajo që ndodh përditë me negociatat për një anëtarësim të mundshëm të vendit tonë në Bashkimin Evropian. Mendoj se në këtë studim jam përpjekur të paraqes një informacion përmbledhës mbi evolucionin e marrëdhënieve Shqipëri-BE në fushën e përafrimit të legjislacionit.

## **Abstract**

The integration process of Albania in European Union is considered as the most national strategic priority which prior the government agenda of the country. From June 2014, Albania has had the candidate status to join the EU. However, the criteria that are placed by the European Union for membership are just preconditions to pass to the next phase of the process which is the opening of the negotiations. In this graduation project is observed the relationship between the Albania and the European Union. In the second chapter it is mentioned the issue of the stabilization and association agreement and European integration. In the third chapter is taken in discussion the chronological relationship between our country and EU. In the fourth chapter is mentioned the approximation of the Albanian legislation with EU acquis.

I have chosen this topic for my graduation project because it is a nowadays topic where all the Albanians are interested in what happens in the negotiations of our country in the EU. I think that in this graduation project I have tried to give a summary information about the evolution of the relationship between Albania and EU in the approximation field of the legislation.

## **FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE**

Dua të shpreh falenderime dhe mirënjohje të thellë ndaj disa personave, të cilët më ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia.

Mirënjohje pafund edhe për udhëheqësin tim, të nderuarin Prof. Asoc. Dr. Arbër Gjeta, i cili përveç ndihmesës dhe udhëheqjes në realizimin e këtij punimi, më ka trasmetuar bazën, ideologjinë dhe filozofinë e së drejtës në tërësinë e saj.

Faleminderit nga zemra!

Gjithashtu, i shpreh mirënjohjen time stafit akademik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” dhe sidomos stafit akademik të programit master në Ekonomi dhe e Drejta në Tregjet Ndërkombëtare.

Së fundmi, dëshiroj të shpreh mirënjohje pafund ndaj familjes time, të cilës i detyrohem shumë për fillimin, zhvillimin, finalizimin dhe mbylljen me sukses të këtij cikli arsimor.

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

Abstrakt

I-II

Mirënjohje

III

Lista e shkurtimeve të përdorura

## **KAPITULLI I**

### **HYRJE**

1.1 Qëllimi

1.2. Metodologjia e përdorur

1.3 Struktura e tezës

## **KAPITULLI II**

### **MSA në kuadër të Integrimit Evropian**

2.1 Ndërtimi i MSA-së dhe strukturat vepruese të saj

2.2 Misioni dhe objektivat e procesit të stabilizim asociimit

2.3 Partneriteti Evropian dhe zbatimi efektiv i MSA-së

2.4 Ecuria e ratifikimit të MSA-së

## **KAPITULLI III**

### **Fazat e antarësimit të Shqipërisë në BE**

3.1 Kriteret e Kopenhagës

3.2 Hapat e bisedimeve për antarësim

3.3 Struktura institucionale Shqiptare për Integrimin Evropian dhe kompetencat e tyre

3.4 Strukturat e përbashkëta monitoruese

## **KAPITULLI IV**

### **Historiku i zgjerimit të BE-së dhe procesi i antarësimit të Shqipërisë**

4.1 Prespektiva e Turqisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e zgjerimit

4.2 Kronologjia e marrëdhënieve me BE

4.3 Sfidat e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian

4.4 Kostot dhe përfitimet e Shqipërisë drejt integrimit evropian

## **KAPITULLI V**

### **Përafrimi i legjisllacionit si kusht për anëtarësimin në BE**

5.1 Përafrimi i legjisllacionit shqiptar me Acquis Communautaire

5.2 Përfshirja institucionale i acquis

5.3 Shanset e Shqipërisë përballë murit të BE-së

5.4 Manuali i hartimit të ligjeve

## **KAPITULLI VI**

### **KONKLUSIONE**

6.1 Konkluzione dhe rekomandime për të ardhmen

### **BIBLIOGRAFIA**

## **Lista e shkurtesave të përdorura**

BE-Bashkimi European

MSA-Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

IPA-Instrumenti i para anëtarësimit

KE-Komuniteti European

OBT-Organizata Botërore e Tregtisë

CARDS-Community Assistance for Reconstruction Development and Stabilisation-  
Programet e Asistencës Komunitare për Zhvillimin Rindërtues dhe Stabilizimin

IPA- Instrument for Pre-accession Assistance-Instrumenti për Ndhimën e Para Anëtarësimit

TKE -Traktati i Komunitetit European

PSA- Procesi i Stabilizim Asociimit

PKZMSA-Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

TAIEX-Technical Assistance and Information Exchange- Instrumenti i Asistencës Teknike  
dhe Shkëmbimit të Informacionit,

PHARE- The Programme for Harmonised ATM Research in EUROCONTROL. Objektivi i  
PHARE është të organizojë, koordinojë dhe kryejë studime dhe eksperimente për të  
demonstruar realizueshmërinë dhe përfitimet e një sistemi të ardhshëm të menaxhimit të  
trafikut ajror në tokë ajrore në të gjitha fazat e fluturimit.

MIE - Ministria e Integrimit Evropian

SKZHI-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

# **Kapitulli I**

## **1.1 Qëllimi**

Çdo studim apo analizë domosdoshmërisht duhet të ketë një qëllim në mënyrë që të përcaktohen hapat dhe metodat e realizimit të qëllimit. Prandaj, edhe në kuadër të këtij punimi diplome nuk mund të realizohet pa pasur një qëllim. Qëllimi i kësaj teme diplome është që nëpërmjet informacionit të mbledhur të paraqesë kronologjinë e marrëdhënieve Shqipëri-BE në përafrimin e legjislacionit.

## **1.2 Metodologjia**

Metodologjia e përdorur i përmbanë këto elemente:

- Grumbullimin dhe përzgjedhjen e materialit (literaturës);
- Analizimin dhe strukturimin e materialit të grumbulluar dhe
- Përpunimi i materialit me të dhëna reale

## **1.3 Struktura e tezës**

Tema është e organizuar në tre pjesë: hyrje, pjesën bazë (zhvillimi i temës) dhe pjesën e tretë (konkluzione, bibliografia). Tema është ndarë në kapituj, pjesë, dhe nënpjesë. Në kapitullin e dytë kam trajtuar çështjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe integritit European. Në kapitullin e tretë kam marrë në shqyrtim kronologjinë e marrëdhënieve të vendit tonë me BE-në. Në kapitullin e katërt kam folur për Përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis-in* e BE-së. Në kapitullin e pestë kam vendosur referencat dhe rekomandimet për të ardhmen gjithashtu dhe bibliografinë.



## KAPITULLI II

### MSA në kuadër të Integritimit Evropian

**Marrëveshja e Stabilizim – Asocimit** është një marrëveshje ligjore ndërkombëtare ndërmjet vendit nënshkrues në rastin tonë Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian mund të realizohet vetëm me anë të zbatimit të një marrëveshje paraprake, e cila parashikon përkrahimin e disa etapave progresive deri në arritjen e qëllimit final. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) mbështetet në një bazë juridike të përshtatshme që hap rrugën drejt integritimit të plotë në BE. Kjo marrëveshje ka për qëllim, nga njëra anë, të afrojë Shqipërinë me Bashkimin Evropian duke krijuar mekanizma që lejojnë bashkëpunimin për interesat e përbashkëta të palëve dhe, nga ana tjetër, të mos çenojë themelet e ndërtesës europiane duke patur si element thelbësor të saj “acquis communautaire”. Është fjala për nenin 310 të Traktatit të Komunitetit Evropian (TKE), i cili është dhe baza juridike e marrëveshjeve europiane<sup>1</sup>, që parashikon: “Komuniteti mund të nënshkruajë me një ose disa Shtete ose organizata ndërkombëtare, marrëveshje që krijojnë një asociim të karakterizuar nga të drejta dhe detyrime reciproke, veprime të përbashkëta dhe procedura të veçanta”. Neni 1 i projekt-marrëveshjes parashikon vendosjen e një asociimi mes palëve, duke krijuar një marrëdhënie juridike të re, që e tejkalon marrëdhënien Shqipëri-Komuniteti Evropian të vendosur nga Marrëveshja e 1992<sup>2</sup>.

Në bazë të këtij asociimi të ofruar nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit palët do të jenë titullarë të detyrimeve dhe të drejtave reciproke si:

- Respektimi i Shtetit të së drejtës dhe i demokracisë, i të drejtave të njeriut dhe minoriteteve si dhe i rregullave të një ekonomie tregu të lirë;
- Krijimi i një zonë të tregëtisë së lirë ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shtetit të asociuar, që do të arrihet me lëshime asimetrike nga palët bazuar në teorinë e spirales, teoria bazë e zhvillimit të Bashkimit Evropian (neni 16 i projekt-Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit)<sup>3</sup>
- Bashkëpunimi rajonal, një detyrim për vendin e asociuar në favor të paqes dhe të stabilitetit, si dhe të zhvillimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.<sup>4</sup>

- Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme;

<sup>1</sup> Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit paraqet pika të përbashkëta me marrëshjen europiane të vitit 90, por dallohet prej tyre nga dispozitat lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe bashkëpunimin në fushat e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme. Shih "Handbook on European enlargement" botuar nga Andrea Ott dhe Kirstyn Inglis, TMC Asser press 2002.

2 Më 11 maj 1992 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen mbi tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik, që përfshinte dialogun politik, regjimin e preferencave të përgjithshme si dhe një ndihmë makro-ekonomike. Baza juridike e marrëveshjes mbi shkëmbimet, tregëtinë dhe bashkëpunimin ekonomik është neni 133(ish 113) i Traktatit të Komunitetit Europian.

3 Ndërsa Marrëveshja mbi shkëmbimin, tregëtinë dhe bashkëpunimin ekonomik nuk parashikon vendosjen e një zone tregëtie të lirë (preambula, Titulli II,III)

<sup>4</sup> Ky bashkëpunim nuk parashikohet në marrëveshjen e 1992.

## **2.1 Ndërtimi i MSA-së dhe strukturat vepruese të saj**

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit është e ndarë në tituj, kapituj dhe nene.

### **Dialogu politik**

Në kuadër të dialogut politik Shqipëria duhet të përshtasë qëndrimet e saj në politikën e jashtme me ato të diplomacisë së Bashkimit Evropian, duke humbur në këtë mënyrë një pjesë të sovranitetit të vet. Ky instrument ka si qëllim të nxisë konvergencën e qëndrimeve të palëve mbi çështjet ndërkombëtare dhe mbi çështjet me interes për një të tjetër palë, zhvillimin e marrëdhënieve të një fqinjësie të mirë si dhe të njëjtin konceptim lidhur me sigurinë në Europë dhe, ç'është më e rëndësishme për t'u evidentuar, në lidhje me të gjitha fushat që janë objekt i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Por duhet theksuar se dialogu politik nuk është një objektiv në vetvete, ai duhet konsideruar si një instrument i rëndësishëm dhe orientuar nga objektivi themelor që është aderimi në BE.

Dialogu politik ka për qëllim të nxisë veçanërisht<sup>5</sup>:

- integrimin e plotë të Shqipërisë në bashkësinë e kombeve demokratike dhe afrimin gradual me Bashkimin Europian;
- një përputhje në rritje e pozicionimeve të Palëve për çështjet ndërkombëtare, gjithashtu nëpërmjet shkëmbimit të duhur të informacionit, dhe në veçanti, lidhur me ato çështje që pritet të kenë efekte të ndjeshme mbi Palët;
- bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë;
- pikëpamje të përbashkëta për sigurinë dhe stabilitetin në Europë, duke përfshirë dhe bashkëpunimin në fushat që mbulohen nga Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët e Bashkimit Europian.

### **Bashkëpunimi rajonal**

Bashkëpunimi rajonal është një nga kapitujt më të rëndësishëm të MSA-së dhe synon ta integrojë Shqipërinë sa më tepër në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Ky është një proces që përfshin të gjitha fushat e bashkëpunimit, që nga ai politik e ekonomik, deri tek bashkëpunimi institucional, social e kulturor. Shqipëria duhet të zhvillojë bashkëpunimin rajonal me vendet që kanë nënshkruar Marrëveshje Stabilizim-Asociimi, vendet e tjera të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe vendet kandidatë për anëtarësim në BE. Nëpërmjet bashkëpunimit rajonal synohet të krijohet një zonë stabiliteti dhe zhvillimi ekonomik në rajonin e Ballkanit. Në të njëjtën kohë bashkëpunimi rajonal paraqet një shans për forcimin e rolit të Shqipërisë në rajon dhe më gjerë si një partner i besueshëm në marrëdhëniet politike dhe tregtare. Bashkëpunimi konsiston në vendosjen e lidhjeve politike dhe ekonomike me anë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve të interesuara. Ky instrument do t'u lejojë këtyre vendeve të mësojnë të jetojnë së bashku, të bashkëpunojnë për të vendosur paqen sociale dhe zhvillimin ekonomik. Marrëveshjet dypalëshe do t'u lejojnë këtyre vendeve të zbatojnë rregullat e një tregu të hapur, i mbështetur në struktura të shëndetshme dhe respektues i rregullave të konkurrencës së lirë. Këto marrëveshje midis vendeve kandidatë për asocim me BE-në kanë si qëllim "trajnimin" e këtyre vendeve me kërkesat ekonomike dhe politike të Tregut të Përbashkët Europian, por dhe me shmangien e konflikteve të interesave nacionale përkatëse.

## **Hapja e tregut**

Shqipëria dhe Komuniteti Evropian do të hapin tregun ndërmjet tyre, gjë që do të thotë se ato do të heqin detyrimet doganore, kufizimet sasiore dhe masat e tjera që kanë këtë efekt për mallrat që do të eksportohen nga Shqipëria në Komunitetin Evropian dhe anasjelltas. Nga ana tjetër, Palët nuk do të marrin masa për mbrojtjen e produkteve kombëtare në tregtinë që do të zhvillojnë ndërmjet tyre. Gjithashtu ndalohet vendosja e detyrimeve të reja doganore për importet ose eksportet, si dhe e kufizimeve të reja sasiore, duke synuar ruajtjen e nivelit ekzistues të hapjes së tregut ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

## **Drejtësia, liria dhe siguria**

Në këtë fushë të Marrëveshjes Shqipëria duhet të bashkëpunojë me Bashkimin Evropian për të forcuar institucionet e saj në të gjitha nivelet, por në veçanti ato institucione që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve synon fuqizimin, pavarësinë dhe efektshmërinë e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe strukturave të tjera përgjegjëse për vendosjen dhe respektimin e shtetit ligjor. Bashkëpunimi në fushën e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë do të mbështetet në dy shtylla kryesore. Shtylla e parë lidhet me bashkëpunimin në fushën e lëvizjes së lirë të personave dhe parashikon një sërë dispozitash për vizat, azilin, migracionin, menaxhimin e kufirit dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e lire të njerëzve. Shtylla e dytë lidhet me bashkëpunimin në luftën kundër fenomeneve të krimit të organizuar, terrorizmit, pastrimit të parave dhe drogave të paligjshme dhe parashikon dispozita sipas të cilave Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të angazhojnë strukturat e tyre policore dhe gjyqësore në një luftë të përbashkët kundër fenomeneve të lartpërmendura.

## **Politikat sektoriale**

Politikat sektoriale përfshijnë një numër të madh fushash, disa prej të cilave janë me rëndësi strategjike për Shqipërinë, si: transporti, energjia, bankat, turizmi, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme etj. Shqipëria do të përfitojë asistencë për ristrukturimin dhe rimëkëmbjen e këtyre sektorëve. Megjithatë, asistenca e Bashkimit Evropian nuk do të thotë investime direkte në sektorët e lartpërmendur, por do të jetë e përqendruar në forcimin e kapaciteteve dhe ngritjen e strukturave të nevojshme për zhvillimin me efikasitet të politikave sektoriale.

## **Asistenca financiare**

Bashkimi Evropian, në kuadër të politikave për t'u zgjeruar duke përfshirë vendet në lindje të kontinentit evropian, ka patur një angazhim konkret në Ballkanin Perëndimor që prej vitit 1991. Programet e ndihmës për Shqipërinë kanë qenë PHARE dhe CARDS. Këto programe kanë synuar të ndihmojnë Shqipërinë për të përparuar në procesin e Integritimit Evropian, duke u përqendruar (sidomos programi CARDS) tek rindërtimi i vendit, zhvillimi dhe stabilizimi i arritjeve në planin politik, ligjor dhe ekonomik. Programi i ri i asistencës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë quhet IPA (Instrumenti i Para anëtarësimit). Ky program i ri asistence do të marrë në konsideratë ndryshimet e ndodhura në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, si dhe fazën e tanishme të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Nëpërmjet IPA-s Bashkimi Evropian do ta ndihmojë Shqipërinë të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

### **2.2 Misioni dhe objektivat e procesit të stabilizim asociimit**

Proçesi i Stabilizim-Asociimit përbën një politikë afrimi e cila reflekton rëndësinë politike dhe strategjike të Ballkanit për Bashkimin Evropian. Proçesi i Stabilizim Asociimit me anë të instrumentave të tij Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Partneritetit Evropian dhe programit të asistencës, CARDS<sup>15</sup>, (Community Assistance for Reconstruction Development and Stabilisation) ndihmon secilin vend të plotesoje kriteret e Kopenhagenit dhe të përparojë sipas ritmit të tij drejt anëtarësimit në BE. Instrumenti kryesor, nëpërmjet të cilit do të krijohen marrëdhëniet ndërmjet BE dhe këtyre vendeve, do të jetë një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi.

Në të do të parashikohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që palët duhet të zbatojnë në kuadër të realizimit të qëllimit përfundimtar: integritet të tyre në Bashkimin Evropian. Cdo hap i mëtejshëm në marrëdhëniet ndërmjet tyre, do të vijë pas monitorimit të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra në këtë Marrëveshje. Këto Marrëveshje, kontribuojnë në arritjen e objektivave të BE, nëpërmjet: (a) sigurimit të mekanizmave formalë dhe metodave që lehtësojnë procesin e “komunikimit” me BE, (b) fokusojnë vëmendjen në respektin për parimet thelbësore të demokracisë- të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, institucionet demokratike të qëndrueshme, standartet e sjelljes politike dhe pavarësisë së mediave dhe (c) përfshijnë elementët themelorë të cilat janë në zemër të tregut të përbashkët të BE-së. Ashtu si për të gjitha vendet që aplikojnë për tu anëtarësuar në BE, edhe për vendet e përfshira në këtë proces, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme, përcaktonte një sërë kushtesh politike dhe

ekonomike që vendet e Ballkanit duhej të plotësonin për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet e tyre me BE-në. Këto kritere lidheshin me kriteret e Kopenhagenit, dhe fokusoheshin në: respektimin e parimeve demokratike, liritë dhe të drejtat e njeriut, ndërtimin, respektimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen e minoriteteve, zhvillimin e ekonomisë së tregut, bashkëpunimin rajonal, përafrimin e legjislacionit si dhe forcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e reformave.

### **2.3 Partneriteti Evropian dhe zbatimi efektiv i MSA-së**

Qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit është vendosja e stabilitetit politik dhe ekonomik të shtetit kandidat. Pikërisht për këtë arsye kjo marrëveshje përmban detyrime asimetrike në favor të tij.

Marrëveshjet kontribuojnë në plotësimin e kriterëve të anëtarësimit në BE sipas mënyrës së mëposhtme:

- Ato janë një mjet i cili siguron, ngjashmërisht me Marrëveshjet evropiane për vendet e Evropës Qendrore, mekanizmat formalë dhe metodat e bashkëpranuara që lejojnë BE-në të punojë me secilin vend për t'a sjellë më pranë standarteve të zbatueshme në BE.
- Ato janë një mjet që shërben për të fokusuar vëmendjen në respektin për parimet thelbësore të demokracisë- të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, institucionet demokratike të qëndrueshme, standartet e sjelljes politike dhe pavarësisë së mediave.
- Ato përfshijnë elementët themelorë të cilat janë në zemër të tregut të njehsuar të BE-së. Përmes tregëtisë së lirë me BE-në dhe disiplinave të bashkëshoqëruara me to (konkurrenca dhe rregullat e ndihmës shtetërore, pronësia intelektuale etj) si dhe përmes të drejtave (psh. profesionet), ky proces do të lejojë ekonominë e rajonit të fillojë të integrohet me ato të BE-së.

Zbatimi efektiv i Marrëveshjeve të Stabilizimit dhe Asociimit është një parakusht për ndonjë vlerësim të mëtejshëm prej BE-së rreth prespektivave për praninë të vendeve përkatëse. Çdo vend do të ketë nevojë për kohë, ndihmë dhe inkurajim për të zbatuar obligime të tilla në mënyrë të përshtatshme.

## **Partneriteti Evropian<sup>16</sup>**

Dokumenti i Partneritetit Evropian identifikon objektivat dhe prioritetet për veprim në mbështetje të përpjekjeve për arritjen e standarteve të Bashkimit Evropian. PE do të shërbejë si një kuadër objektivash dhe kriteresh në bazë të të cilave do të matet progresi i Shqipërisë në Proçesin e stabilizim-asocimit. Partneriteti Evropian do të shërbejë gjithashtu edhe si kuadër për të orientuar ndihmën financiare të Komunitetit nëpërmjet programit CARDS.

Në përgjigje të dokumentit të Partneritetit Evropian, Qeveria e Republikës së Shqipërisë përgatiti kete Plan kombëtar veprimi.

### **Kuptimi dhe përdorimi i Planit të Veprimit**

Partneriteti Evropian është instrument i Proçesit të stabilizim-asocimit. Plani i Veprimit për zbatimin e Partneritetit Evropian për Republikën e Shqipërisë përfaqëson një përpjekje të gjithanshme të institucioneve shqiptare për të evidentuar në mënyrë të strukturuar e të integruar masat dhe veprimet që duhen ndërmarrë për të vënë në jetë objektivat prioritare të Proçesit të stabilizim-asocimit në një periudhë afat-shkurtër (një deri në dy vjet) dhe afat-mesme (tre deri në katër vjet).

### **Qëllimi i tij është të pershkruajë në një kuadër të vetëm:**

- Fushat prioritare në të cilat nevojiten përmirësime të mëtejshme,
- Objektivat e përgjithshme dhe specifike prioritare për arritjen e standarteve të kërkuara nga proçesi i Stabilizim Asocimit në këto fusha,
- Masat për arritjen e objektivave si edhe veprimet përkatëse të detajuara për zbatimin e çdo mase,
- Institucionet përgjegjëse si edhe afatet kohore për realizimin e çdo mase apo veprimi,
- Mjetet financiare të nevojshme për çdo masë.

Plani i Veprimit është përgatitur duke u bazuar në qëndrimin konstant të qeverisë dhe partnerëve vendas e të huaj për përdorimin e objektivave të integritit Evropian si fokus për politikatat e zhvillimit të vendit, për të mbështetur konsensusin dhe bashkëpunim politik në vend, si edhe për të rifreskuar angazhimet politike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në proçesin e Stabilizim-Asocimit. Ky Plan duhet të konsiderohet si një kuadër masash, zbatimi i të cilave do të kontribuojë në mënyrë të qenësishme për forcimin e institucioneve

e kapaciteteve të administratës Shqiptare, përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, rritjen e efektivitetit të zbatimit të reformave, konsolidimin e monitorimit gjithëpërfshirës, dhe menaxhimin e procesit dhe progresit duke u bazuar në rezultate të paracaktuara, konkrete, të matshme.

### **Ky Plan Veprimi synon;**

- të shërbeje si një instrument veprimi dhe vet-monitorimi për nivelet vendimmarrëse në Shqipëri; Kuvendin, qeverisjen qendrore e vendore.
- të shërbeje si kuader monitorimi nga Komisioni Evropian për të matur progresin e Shqipërisë në procesin e Stabilizim Asociimit
- të shërbejë gjithashtu si instrument gjithëpërfshirës dhe monitorimi për shoqërinë civile dhe mediat, komunitetin e biznesit, publikun e gjerë për stimulimin e debatit mbi politikën dhe progresin e Shqipërisë në rrugën e Stabilizim Asociimit.
- të shërbejë si kuadër udhëzues për programimin e asistencës komunitare për Shqipërinë nëpërmjet programit CARDS dhe programeve e nismave të tjera komunitare, si dhe për planifikimin e financimeve buxhetore për masat prioritare në kuadër të Programit Buxhetor Afat-mesëm

### **2.4 Ecuria e ratifikimit të MSA-së <sup>17</sup>**

Pavarësisht problematikave që mbart Shqipëria në tranzicionin e saj të gjatë e të lodhshëm, më 1 prill 2019 mbushen 10 vjet kur hyri zyrtarisht në fuqi Marrëveshja e Stabilizim–Asocimit të BE me Shqipërinë. Negocimi i Marrëveshjes së Stabilizim–Asocimit mes Shqipërisë e BE-së ofroi sfidën e parë të përballjes së kapaciteteve teknike e institucionale të vendit, në një proces negociatash, që zgjati 3 vjet 31.01.2003-01.06.2006 dhe që u pasua nga një periudhë 3-vjecare ratifikimi nga vendet e BE (2006-2009). Në këtë mënyrë, Procesi i Stabilizimi–Asocimit, që u pasua nga modeli i Marrëveshjeve të Stabilizim-Asocimit – MSA do të ishte për Shqipërinë jo vetëm nisja e një procesi jo të lehtë transformimi gradual në të gjitha fushat, por tashmë një pikë kthese drejt anëtarësimit të BE-së. Si një instrument i rëndësishëm politik dhe ekonomik, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, MSA-ja, do të hidhte bazat e një partneriteti të qëndrueshëm me Bashkimin Europian, duke bërë një element të matshëm zbatimin e detyrimeve të saj nga ana e Shqipërisë përmes Progres-



Raporteve të përvitshme të Komisionit Evropian. Që prej vitit 2000 deri në 31 janar 2003 kur kryekomisioneri Prodi njoftoi zyrtarisht hapjen e negociatave mes Shqipërisë e BE-së për nënshkrimin e MSA, kalendari kohor i ngjan një maratone procesesh që do të ndjehej përgjatë gjithë kësaj periudhe. Në qershor 2001, Këshilli i Ministrave të Jashtëm të BE-së miraton raportin e Komisionit Evropian mbi progresin e bërë nga Shqipëria dhe i kërkon Komisionit përgatitjen e projekt-direktivës për negocimin e një Marrëveshjeje Stabilizim-Asocimi (MSA) me Shqipërinë. Por, që para hapjes së negociatave me BE-në për MSA nga pala shqiptare u pranua monitorimi i procesit të reformave, nëpërmjet një mekanizmi unik të quajtur Grupi i Përbashkët Konsultativ Shqipëri-BE. Një praktikë e tillë vazhdoi edhe pas hapjes së negociatave, duke shënuar një veçori për rastin e Shqipërisë. Takimet e Grupit Konsultativ të Përbashkët kanë trajtuar progresin e bërë në ecurinë e reformave sektoriale në të gjitha drejtimit si: procesin zgjedhor, Situatën politike, çështjet e drejtësisë dhe punëve të brendshme, çështjet e ekonomisë dhe financave.

Pasi u krijua Grupi Konsultativ BE-Shqipëri në 2002, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE miratoi projekt-direktivën për negocimin e një MSA-je dhe vendosi hapjen e negociatave për nënshkrimin e një MSA-je me Shqipërinë. MSA-ja rikonfirmonte të ashtuquajturat kritere të Kopenhagenit dhe mbështetet mbi disa parime bazë, duke filluar nga respekti për parimet demokratike, të drejtat e njeriut, ligjin ndërkombëtar, shtetin ligjor si dhe respektin për parimet e ekonomisë së tregut .

Vendi i parë (dhe i vetëm për vitin 2006) që e ratifikoi MSA-në BE-Shqipëri ishte Letonia (19 dhjetor 2006).

Gjatë vitit 2007, vijuan ratifikimet nga plot 14 vende të tjera (Slloveni, Spanjë, Hungari, Suedi, Irlandë, Sllovaki, Lituani, Poloni, Luksemburg, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Estoni, Holandë dhe Finlandë).

Vendet e tjera anëtare (Danimarkë, Maltë, Austri, Republika Çeke, Qipro, Portugali, Belgjikë, Francë dhe Gjermani) e përmbyllën procesin e ratifikimit brenda vitit 2008.

Me mbylljen e ratifikimit nga Greqia në janar 2009, dhe pas dorëzimit të pritshëm të instrumenteve të ratifikimit në KE, përfundon dhe procesi i ratifikimit të MSA-së, i cili së bashku me nënshkrimin Protokolleve të Zgjerimit me dy vendet e reja anëtare (Rumania dhe Bullgaria), i hapi udhë hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Me mbylljen e ratifikimit nga Greqia në janar 2009 dhe pas dorëzimit të pritshëm të instrumenteve të ratifikimit në Komisionin Europian përfundon edhe procesi i ratifikimit të MSA-së, i cili së bashku me nënshkrimin Protokolleve të Zgjerimit me dy vendet e reja anëtare (Rumania dhe Bullgaria), i hapi udhë hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje më 1 prill 2009. Por, nga nënshkrimi i MSA-së në 2006 deri në hyrjen e saj në fuqi në 1 prill 2009, një tjetër marrëveshje do të rregullonte marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe BE-së, që do të ishte “Marrëveshja e Ndërmjetme për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian”. Marrëveshja e Ndërmjetme vendosi baza të qëndrueshme të reciprocitetit në lidhje me detyrimet dhe të drejtat në fushën e tregtisë mes Shqipërisë e BE, por duke favorizuar Shqipërinë për eksportet e saj drejt BE. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Bashkimi Evropian liberalizoi pothuajse tërësisht të gjitha linjat tarifore me Shqipërinë menjëherë në dhjetor 2006, me përjashtim të disa produkteve bujqësore sensitive, të cilat vazhduan të jenë nën masa mbrojtëse. Ndërsa, liberalizimi tarifor nga pala shqiptare, në linjë me Marrëveshjen e Ndërmjetme, u përmbush në mënyrë të përshkallëzuar deri në vitin 2011, në mënyrë që t’i jepej kohë tregut shqiptar dhe operatorëve ekonomikë për të fuqizuar kapacitetin e tyre për të konkurruar.

15 CARDS-Community Assistance for Reconstruction Development and Stabilisation- Programet e Asistencës Komunitare për Zhvillimin Rindërtues dhe Stabilizimin

16 M arrë nga faqe online <https://eksplorobe.com/procesi-i-stabilizim-asocimit/>

17 Marrë nga Ëikipedia

## KAPITULLI III

### Fazat e antarësimit të Shqipërisë në BE

Aplikimi për anëtarësim në Bashkimin Evropian fillon zyrtarisht kur vendi aspirant i dorëzon aplikimin për anëtarësim Presidencës së BE-së. Komisioni Evropian ofron një opinion formal për vendin aplikues, duke rekomanduar dhënien ose jo të statusit të vendit kandidat dhe hapjen e negociatave. Në momentin që Këshilli në unanimitet bie dakord mbi një mandat negociues, bisedimet midis vendit kandidat dhe të gjitha Shteteve Anëtare të BE-së mund të hapen formalisht. Para se të fillojnë negociatat, vendi aplikant duhet të plotësojë kriteret e antarësimit në BE.

Në vitin 2009 Shqipëria paraqiti kërkesën e saj zyrtare për antarësim në Bashkimin Evropian. Komisioni Evropian paraqiti një opinion (në vitin 2010), me kërkesën e Këshillit Evropian në lidhje me aplikimin për antarësim, duke vlerësuar se Shqipëria kishte ende për të përmbushur 12 prioritetet kyçe, në mënyrë që të arrinte një shkallë të nevojshme të pajtueshmërisë me kriteret e antarësimit.

Në tetor të vitit 2012, Komisioni rekomandoi që Shqipërisë t'i jepej statusi i kandidatit të BE, në varësi të përfundimit të reformave, veçanërisht në fushat e reformës së gjyqësorit dhe administratës publike.

Në qershor të vitit 2014, Këshilli Evropian i dha Shqipërisë statusin e kandidatit. Marrja e statusit të vendit kandidat shënon një hap shumë të rëndësishëm në procesin e integritit të Shqipërisë në BE, pasi reflekton ecurinë e reformave të ndërmarra dhe i hap rrugë procesit të plotë të aderimit të vendit në BE.

**Hapi tjetër i radhës në këtë proces është hapja e negociatave (bisedimeve) për antarësimin në BE, i kushtëzuar nga përmbushja e plotë e 5 prioritetëve kyçe si:**

1. Krijimi i një administrate profesioniste dhe të depolitizuar;
2. Forcimi i pavarësisë të institucioneve të drejtësisë;
3. Lufta kundër korrupsionit;
4. Lufta kundër krimit të organizuar;
5. Mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Pas përmbushjes së këtyre 5 prioriteteve, detyra e Shqipërisë gjatë procesit të negociatave do të jetë miratimi dhe vënia në zbatim e të gjithë acquis të BE-së, të cilat ndahen në 35 kapituj, ecuria e secilit prej tyre monitorohet dhe vlerësohet nga Komisioni Evropian. Vetëm pasi bisedimet dhe reformat shoqëruese kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme për të dyja palët (Shqipëri dhe BE), vendi mund t'i bashkohet unionit. Në kuadër të procesit monitorues, Komisioni Evropian mat periodikisht progresin e Shqipërisë në përmbushjen e agjendës evropiane nëpërmjet Raporteve të Progresit të cilat publikohen një herë në vit.

### **3.1 Kriteret e Kopenhagës**

Kriteret e Kopenhagës apo kriteret e pranimit janë kushtet thelbësore, që duhet t'i plotsojnë të gjitha vendet candidate për t'u bërë një shtet anëtarë i Bashkimit Evropian, kriteret të cilat u vendosen në qershor 1993, në mbledhjen e Këshillit Evropian të Kopenhagenit dhe në Këshillin Evropian të Madridit të vitit 1995. Këto kriteret të anëtarësimit u përcaktuan në Këshillin Evropian në qershor të vitit 1993 në Kopenhagë Danimarkë, nga i cili ato marrin emrin e tyre. Këto kriteret kërkojnë që një shtet të ketë institucione për të ruajtur qeverisjen demokratike dhe të drejtat e njeriut, të ketë një ekonomi tregu funksionale dhe të pranojë detyrimet dhe synimin e BE-së.<sup>18</sup>

#### **Kriteret e Kopenhagës përfshijnë:**

1. Kriteret Politike
2. Kriteret Ekonomike
3. Kriteri i “acquis Communautaire”

#### **1. Kriteret Politike**

Kemi të bëjmë me stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë duke mundësuar pjesëmarrjen efektive të qytetarëve në procesin legjislativ, bazuar në zgjedhjet shumëpartiake, të lira dhe të ndershme. Parlamenti duke përmbushur kriteret politike, duhet të veprojë në mënyrë të kënaqshme, kompetencat e tij të respektohen dhe opozita të luaj rol të plotë në aktivitetet e saj. Sundimi i ligjit tregon nivelin e procesit gjyqësor, gjyqtarë të pavarur nga ndikimi i ekzekutivit, kompetencën e gjyqtarëve, mundësinë e zgjidhjes së mosmarrveshjeve, mosdiskriminimin në procesin gjyqësor dhe efikasitetin e policisë.

#### **2. Kriteret ekonomike përfshijnë:**

- Ndërtimin e një ekonomie të lirë të tregut
- Prodhim të fortë vendorë për të përballuar konkurrencën brenda BE-së
- Rritja reale e prodhimit të brendshëm Bruto, inflacionit, bilancit buxhetor të përgjithshëm të qeverisë, papunësisë, borxhit të jashtëm dhe investimeve të huaja direkte
- Kalimi në përdorimin e monedhës Euro

Ndërtimin e një ekonomie funksionale të tregut, ashtu si e ka bërë BE-ja, nga themelimi i saj, në krijimin e tregut të përbashkët për thëngjill e çelik, disa vite më vonë, krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian , për të krijuar një bashkim doganor dhe atë të Energjisë Atomike për bashkëpunimin në zhvillimin e energjisë bërthamore, angazhimi në mënyrë sistematike për arritjen e një ekonomie të lirë të tregut (ekonominë e përbashkët), për tregun e lirë dhe pa pengesa, lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, fuqisë punëtore. Mallrat dhe shërbimet tregtohen lirshëm midis vendeve anëtare. Nuk lejohet asnjë lloj takse diskriminuese, tarifë apo barriera të tjera.

### **3. Kriteri i *acquis Communautaire***

Është platformë e të drejtave dhe detyrimeve që duhet të respektojë një shtet anëtarë në kontekstin e integritimit evropian. *Acquis* pra i referohet rregullave dhe politikave të Bashkimit Evropian.Në përgjithësi, një shtet kandidat që përgatitet për pranim në BE, duhet të rrisë kapacitetet menaxheriale dhe administrative si dhe sistemet gjyqësore në vijë me standardet e BE-së, me përpjekjen për të zbatuar *Acquis* në mënyrë efektive, ose, siç mund të ndodh, të jetë në gjendje të zbatojë atë në kohë të përshtatshme para pranimit.

*Acquis* përfshin të gjitha traktatet dhe ligjet e BE-së (direktivat, rregulloret, vendimet), deklaratat dhe rezolutat, marrëveshjet ndërkombëtare dhe gjykimet e Gjykatës së Drejtësisë. Ai gjithashtu përfshin veprime që qeveritë e BE ndërmarrin së bashku në fushën e Drejtësisë dhe çështjeve të Brendshme (Liria, Siguria dhe Drejtësia) dhe Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë -por ajo përjashton vendimet për krijimin e marrëveshjeve të "bashkëpunimit të zgjeruar". Kur shtetet aderuese përgatiten të anëtarësohen në BE, ata duhet të pranojnë të gjithë *Acquis* ekzistues (tani që përfshin 35 fusha të politikave), ndonjëherë për një periudhë kalimtare, si dhe të vendosin mekanizma për të adoptuar elemente të ardhshëm të *acquis*. Nga data e pranimit, dispozitat e Traktateve origjinale dhe akteve të

miratuara nga institucionet e Komuniteteve do të jenë detyruese për Shtetet e reja Anëtare dhe do të zbatohen në ato Shtete në kushtet e përcaktuara në ato Traktate dhe në këtë akt.

Traktatet e BE-së në vetvete nuk sqarojnë marrëdhëniet midis instrumenteve të ndryshëm që përbëjnë *acquis*, megjithëse është e qartë se disa akte kanë një status të ndryshëm për të tjerët. Disa instrumente janë legjislativ ndërsa të tjerët jo; disa traktate dhe konventa janë marrëveshje ndërkombëtare midis Shteteve Anëtare, por nuk përfshijnë mekanizmat institucional të BE-së dhe mund të mos jenë subjekt i juridiksionit të Gjykatës së Drejtësisë.

Këshilli dhe Komisioni janë të autorizuar në bazë të Traktatit për të bërë ligje. Këshilli mund të miratojë legjislacion vetëm me një propozim të Komisionit, i cili ka të drejtën e vetme të iniciativës në propozimin e legjislacionit. Komisioni gjithashtu mund të miratojë legjislacion nën kompetencat e deleguara. Kjo zakonisht vlen për zbatimin e masave të një natyre rutinore ose të përditshme. Në teori, dy llojet e legjislacionit duhet të kenë peshë të barabartë pasi që të dy institucionet nuk janë në mënyrë hierarkike të ndryshme dhe të dy fuqizohen nga Traktati për të bërë ligje. Sidoqoftë, është diskutuar para Gjykatës së Drejtësisë se ligjet e Këshillit kanë peshë më të madhe se ato të Komisionit, dhe se në rast të një konflikti midis një rregulloreje të Këshillit dhe një rregullore në zbatim të Komisionit, i pari duhet të mbizotërojë.

### **3.2 Hapat e bisedimeve për antarësim**

Vendimi për hapjen e bisedimeve për antarësim, merret atëherë kur BE-ja vlerëson se vendi kandidat ka plotësuar kriteret politike dhe ekonomike, pra, është një demokraci funksionale dhe një ekonomi e lirë e tregut. Bisedimet për antarësim nuk mund të fillojnë derisa të gjitha vendet e BE-së të bien dakord, me një vendim të njëzëshëm të Këshillit të BE-së, për bisedime (negociata) me vendin kandidat. Korniza e bisedimeve përcakton udhëzimet dhe parimet për bisedimet për antarësim me çdo vend kandidat. Kuadri negociues hartohet nga Komisioni Evropian dhe miratohet nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Më pas, Presidenca e radhës e Këshillit Evropian ia paraqet atë shtetit kandidat në fillim të negociatave për antarësim.

Bisedimet për antarësim janë të rëndësishme, pasi ato jo vetëm ndihmojnë vendin kandidat për përmbushjen e detyrimeve të antarësimit në Bashkimin Evropian, por i krijojnë mundësi edhe BE-së të përgatitet për zgjerimin e radhës. Bisedimet kanë të bëjnë me miratimin dhe vënien në zbatim të gjithë *acquis* të BE-së, të cilat ndahen në 33 kapituj dhe ecuria në çdonjërin prej tyre monitorohet dhe vlerësohet nga Komisioni Evropian. Secili kapitull

diskutohet më vete dhe në bazë të situatës ose ecurisë, mund të përcaktohen kritere/standarde të matshme për hapjen dhe mbylljen e secilit kapitull. Këshilli dhe vendi kandidat analizojnë ligjet kombëtare dhe ato të BE-së për të përcaktuar dallimet mes të dyjave. Kështu, bisedimet janë mundësia që vendet candidate kanë për të bindur BE-në se aftësia administrative e vendit të tyre është e gatshme të zbatohet ligjin Evropian. Kapitulli quhet i mbyllur kur të dy palët kanë rënë dakord se ai është zbatuar mjaftueshëm.

Bisedimet (Negociatat) për çdo kapitull bazohen në elementet e mëposhtme<sup>19</sup>:

**Shqyrtimi -Screening.** Komisioni Evropian, së bashku me vendin kandidat, kryen një kontroll të hollësishëm të politikave (të çdo kapitulli), për të përcaktuar përgatitjen e vendit kandidat. Shqyrtimi për çdo kapitull mbahet në dy faza.

**Faza shpjeguese** –faza ku vendi kandidat ,mëson’ rreth kërkesave që duhet të plotësojë. Komisioni Evropian paraqet acquis bazuar në një listë aktesh ligjore. Takimet shpjeguese mund të zgjasin nga 1 deri në 9 ditë pune për kapitujt më voluminozë, të tilla si bujqësia apo mjedisi.

**Shqyrtimi dypalësh** –faza ku vendi kandidat ‘testohet’ për nivelin e të kuptuarit dhe gatishmërinë e administratës për të ndërmarrë detyrimet. Vendi kandidat shpreh qëndrimin e vet nëse e pranon ose jo acquis dhe nëse do të mund ta zbatojë atë menjëherë apo në një të ardhme. Ekspertë nga ministrinë e linjës, si dhe anëtarët e grupeve të punës paraqesin nivelin e harmonizimit të legjislacionit vendas me acquis

**Raporti i Shqyrtimit**-Gjetjet për çdo kapitull, Komisioni ia paraqet shteteve anëtare për miratim në formën e një raporti shqyrtimi. Ato përmbajnë rekomandime nëse bisedimet mund të hapen direkt,(procedura e shkurtër) apo do të duhet të plotësohen më parë disa kushte(procedura e dytë).

**Standardet për hapjen dhe mbylljen e kapitullit**-zakonisht i referohen kuadrit ligjor apo strategjik të nevojshëm për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit; ndërsa standardet për mbylljen e një kapitulli i referohen nivelit të zbatimit të legjislacionit të përafruar. Pas konfirmimit nga ana e Komisionit Evropian dhe shteteve anëtare që standardet e hapjes janë plotësuar, Presidenca e BE-së i dërgon letër shtetit kandidat të paraqesë pozicionin e vet negociues për kapitullin përkatës. I njëjti parim zbatohet edhe kur janë vendosur standarde për hapjen dhe mbylljen e kapitullit, sidhe kur nuk ka standarde shtesë.

**Pozicionet (qëndrimet) negociuese**—Përpara fillimit të bisedimeve, vendi kandidat duhet të paraqesë pozicionin e tij negociues dhe BE duhet të miratojë një qëndrim të përbashkët mbi të. Për përgatitjen e një drafti final të një pozicion negociues, kërkohet angazhimi i të gjithë ekspertizës dhe burimeve të mundshme; marrja në konsideratë e të gjitha komenteve dhe sugjerimeve për të dhënë një pasqyrë të plotë të të gjitha çështjeve kryesore me interes kombëtar dhe se si harmonizimi në këtë kapitull do të reflektojë në politikën kombëtare; konsultime jo zyrtare me Komisionin Evropian, sidomos nëse standardet për hapjen janë përmbushur. Pozicionet negociuese janë një proces delikat, si në aspektin procedural, ashtu dhe atë substancial/thelbësor.

**Projektqëndrim i përbashkët**—Bazuar në pozitën negociuese të vendit kandidatit, Komisioni Evropian përgatit një projektqëndrim të përbashkët të BE-së i cili miratohet nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Ky dokument mund të përmbajë dhe përcaktojë edhe standardet e mbylljes së kapitullit, të përcaktuara nga Komisioni ose të amenduara nga Shtetet Anëtare në Këshill. Për shumicën e kapitujve, BE-ja do të vendosë standardet e mbylljes, (closing benchmarks procedura e tretë) të cilat duhet të përmbushen nga vendi kandidat përpara se bisedimet në atë kapitull të mbyllen.

**Konferenca Dypalëshe Ndërqeveritare.** Të dy pozicionet negociuese shkëmbehen zyrtarisht gjatë Konferencës Ndërqeveritare.

**Pozicioni i Përbashkët Përmbyllës i BE-së.** Pas konfirmimit se të gjitha standardet e mbylljes janë plotësuar, vendi kandidat përgatit një raport mbi përmbushjen e detyrimeve për kapitujt përkatës, ndërsa për palën tjetër, Komisioni Evropian përgatit një Pozicion të Përbashkët Përmbyllës të BE-së, i cili duhet të miratohet nga Shtetet Anëtare në Këshill. Këto dokumente shkëmbehen gjatë Konferencës Ndërqeveritare dhe kështu kapitulli përkohësisht është i mbyllur.

**Mbyllja e kapitujve.** Bisedimet (negociatat) për çdo kapitull të veçantë nuk mbyllen derisa çdo qeveri e vendeve të BE-së të jetë e kënaqur me përparimin e vendit kandidat në atë fushë/sector, sipas analizës/vlerësimit nga Komisioni Evropian. I gjithë procesi i bisedimeve (negociatave) është i lidhur me mbylljen e çdo kapitulli. Në rastin e Kroacisë, bisedimet për anëtarësim zgjatën 6 vjet, gjithsesi ritmi i bisedimeve varet nga shpejtësia e reformave dhe harmonizimit me ligjet e BE-së, prandaj dhe kohëzgjatja e bisedimeve ndryshon dhe nuk ka garanci se kur do të mbyllen. Ajo që dihet është se kapitulli 23 dhe 24 do të hapen të parat dhe do të mbyllen të fundit, gjë që do të përcaktojë ecurinë e procesit të anëtarësimit.



### **3.3 Struktura institucionale Shqiptare për Integrimin Evropian dhe kompetencat e tyre**

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian, mbetet objektivi primar i Qeverive Shqiptare që nga vitet 1990. Me qëllim ndjekjen e këtij procesi, janë krijuar disa struktura, të cilat kanë detyrat e tyre specifike, në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ngritja e këtyre strukturave dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative, që kanë në fokus të punës së tyre procesin e integritit evropian mbetet një nga prioritetet themelore të Dokumentave monitorues të Bashkimit Evropian.<sup>20</sup> Strukturat kryesore që ndjekin këtë proces janë:

**I. Komiteti Ndërmintor për Integrimin Evropian,** e cila është struktura më e lartë institucionale, përgjegjëse për drejtimin në nivelet më të larta politike dhe monitorimin e të gjithë procesit të integritit Evropian në Shqipëri. Ky Komitet drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga ministrat dhe zyrtarë të lartë të institucioneve të tjera qëndrore. Komiteti ndërmintor për Integrimin Evropian mbledhet në mënyrë periodike dhe trajton çështjet më të rëndësishme në lidhje me procesin e integritit Evropian. Një atribut shumë i rëndësishëm i këtij Komiteti është autoriteti që ai ka për të miratuar dhe dhënë mandatin, lidhur me pozicionin negociues të palës shqiptare, përpara zhvillimit të çdo raundi negociatash. Një tjetër rol shumë i rëndësishëm i Komitetit është miratimi i Dokumentave të rëndësishëm, të cilat i dërgohen shërbimeve të Komisionit Evropian, sikurse janë: Kontributi i palës shqiptare për Raportin Vjetor që Komisioni boton për Shqipërinë, materialet e Grupeve të Punës BE- Shqipëri etj.

**II. Ministria e Integritit Evropian,** e cila ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nepërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, hartimit të politikave të integritit, bashkërendimit të ndihmave financiare dhe informimit të publikut për këte proces.

**III. Komisioni Parlamentar për Integrimin,** është struktura më e rëndësishme parlamentare, e cila meret më çështje të integrimit. Ky Komision, diskuton përpara miratimit të gjitha ato projekt-ligje, të cilat synojnë ose duhet të synojnë përputhjen me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Anëtarë të Komisionit, janë deputetë të grupeve të ndryshme politike dhe ky Komision mund të thërrasë për të raportuar Ministrin e Integrimit apo përfaqësues të tjerë të Qeverisë, në kuadër të monitorimit të zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA.

**IV. Grupi ndërministror për monitorimin dhe koordinimin e MSA-së.** Ky Grup është krijuar me Urdhër të Kryeministrit dhe ka si qëllim kryesor, bashkërendimin e punës, në kuadër të zbatimit të MSA-së. Ky Grup bashkëdrejtohet nga Ministri i Integrimit dhe Ministri i Financave dhe në të marrin pjesë Zëvendësministrat ose Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive të Linjës si dhe drejtuesit e Institucioneve të tjera Qendrore. Ky Grup mund të krijojë nëngrupe ekspertësh, sipas fushave të caktura dhe mbledhet periodikisht.

**V. Njësitë e Integrimit Evropian në Ministrinë e Linjës.** Njësitë e Integrimit janë struktura të cila bashkërendojnë punën e institucioneve ku bëjnë pjesë me Ministrinë e Integrimit. Ato shërbejnë si “urë lidhëse” ndërmjet Ministrive të Linjës dhe Ministrisë së Integrimit dhe janë ngritur me qëllim përshpejtimin e procesit të integrimit. Aktualisht çdo Ministri ka Njësinë e saj të Integrimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, për ngritjen dhe funksionimin e tyre.

**VI. Ministria e Punëve të Jashtme** – Drejtoria e Integrimit Evropian, është përgjegjëse për promovimin, njohjen, dhe mbështetjen e Procesit të Stabilizim Asocimit në nivelet më të larta politike të Bashkimit Evropian. Në kuadrin e Politikës së Jashtme, Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për rritjen dhe forcimin e dialogut politik me shtetet anëtare dhe vende të tjera në përkrahje të Procesit të Stabilizim Asocimit. Së fundmi, Ministria e Punëve të Jashtme, po bën lobizëm për ratifikimin e MSA nga parlamentet e vendeve anëtare.

**VII. Grupi Negociator për Integrimin Evropian,** është Grupi i cili ka drejtuar procesin e negociatave për nënshkrimin e MSA-së. Ky Grup, drejtohet nga Kryenegociator i cili është Ministri i Integrimit Evropian. Grupi negociator përbëhet

nga përfaqësues të të gjitha ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore të tjera. Ai është përgjegjës për koordinimin, monitorimin, dhe zbatimin brenda institucioneve të tyre të të gjitha veprimtarive sektoriale të lidhura me Procesin e Stabilizim-Asocimit. Grupi ka pushuar së funksionuari që nga Shkurti i vitit 2006, me zhvillimin e raundit të fundit të negociatave. Pas aplikimit për marrjen e statusit të vendit kandidat, pritet të krijohet së shpejti një strukturë, thuajse e njëjtë me këtë Grup Negociator.

20Shprehur në Dokumnetin e Partneritetit European dhe Raportin Vjetor të Komisionit për Shqipërinë, viti 2007

### **3.4 Strukturat e përbashkëta monitoruese**

Me qëllim monitorimin e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, në kuadër të integritit të vendit në Bashkimin Europian, të dy palët kanë rënë dakord për ngritjen e disa strukturave, që mund të jenë: Grupe Pune ose Dokumenta të ndryshme.

**I. Komiteti i Përbashkët BE-Shqipëri**, e cila është struktura më e rëndësishme e përbashkët ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe institucioneve të BE-së. Ky Komitet monitoron ecurinë e reformave për zbatimin e MSA-së, gjatë një periudhe një vjecare. Komiteti përbëhet nga përfaqësues të Komisionit Europian, në varësi të çështjeve që diskutohen. Nga ana e saj pala shqiptare përgatit një material kontribues dhe ja dërgon atë Komisionit Europian, përpara zhvillimit të takimit, në bzë të një axhende paraprake. Në përfundim, gjatë zhvillimit të Takimit, palët diskutojnë mbi reformat e ndërmarra dhe ato që duhet të ndërmeren në vijim nga Qeveria Shqiptare.

**Fokusi kryesor i çështjeve që trajtohen është zbatimi i kriterëve të Kopenhagenit sikurse janë:** a) Stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut, respektin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, marrëdhënieve të mira me fqinjët dhe politikën konsultative në rajon,

(b) Funksionimi i plotë i ekonomisë së tregut, privatizimi i sektorëve strategjikë, përmirësimin e sistemit të taksave dhe aftësisë për të përballuar presionin e konkurrencës të forcave të tregut brenda BE-së si dhe

(c) Aftësia për të marrë përsipër zbatimin e detyrimeve të anëtarësisë së plotë, përfshirë synimin për arritjen e bashkimit politik, ekonomik e monetar.

**II. Grupet e Punës BE-Shqipëri.** Këto Grupe Pune, monitorojnë reformat e ndërmarra në çështje specifike. Ato mbidhen një herë në vit dhe trajtojnë progresin e bërë që nga viti i kaluar. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Ndërmjetme, këto Grupe Punë janë riformuar dhe funksionojnë gjashtë të tillë. Ato janë: (i) Grupi i Punës për Politikën Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, (ii) Grupi i Punës për Politikën Sociale, (iii) Grupi i Punës për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën dhe Ndihmën Shtetëore, (iv) Grupi i Punës për Transportin, Industrinë dhe Energjinë, (v) Grupi i Punës për Bujqësinë, Mjedisin dhe Peshkimin si dhe (vi) Grupi i Punës për Doganat dhe Tregjet.

**III. Takimet e Task Forcës,** janë takime shumë të rëndësishme, ndërmjet palës shqiptare dhe asaj europiane, ku fokusi kryesor i diskutimit janë çështje të politikës së brendshme dhe drejtësisë. Këto takime pasohen nga Rekomandimet e Përbashkëta, të cilat pasqyrojnë diskutimet e bëra gjatë takimeve, çështjet problematike të ngritura në të dhe që duhen zgjidhur, të shoqëruara në pjesën më të madhe me afate kohore të përcaktuara qartë për përmbushjen e tyre. Ndjekja dhe zbatimi në kohë i këtyre rekomandimeve është në fokusin kryesor të punës së Ministrisë së Integritimit Evropian si strukturë koordinuese dhe monitoruese e këtij procesi, në bashkëpunim me ministrin e linjës.

**IV.** Një nga instrumentat kryesorë monitorues të BE-se mbi ecurinë e reformave të ndërmarra nga Shqipëria, dhe zbatimin e tyre është **Raporti Vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë për Procesin e Stabilizimit Asociimit.** Në këto raporte trajtohen me hollësi gjendja e vendit në të gjitha aspektet politike dhe ekonomike, si dhe jepen sugjerime se ku duhet të përqëndrohet vëmendja gjatë 12 muajve të ardhshëm. Raporti vjetor publikohet nga Komisioni Evropian çdo vit për të pesë vendet e Përfshira në Procesin e Stabilizimit Asociimit dhe përben një nga instrumentat kryesorë monitorues të BE-se për ecurinë në reformat në të gjithë sektorët në kuadër të Procesit të Stabilizimit Asociimit.

Raporti është një sintezë e procesit të vazhdueshëm të monitorimit që BE i ka bërë progresit të reformave në Shqipëri gjatë 12 muajve të fundit si në kuadër të Grupit Konsultativ të Përbashkët BE-Shqipëri apo të Grupeve të Përbashkëta të Teknike Punës që mbledhen në mënyrë periodike po ashtu moment i rëndësishëm monitorimi mbetet dhe procesi i negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit gjatë të cilit BE vlerëson kapacitetet tona administrative për të implementuar me pas Marrëveshjen që po negociojmë.

**V. Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit,** është “përgjigja” që Qeveria Shqiptare ka hartuar dhe miratuar pas publikimit të Raportit Vjetor të KE dhe Dokumentit të Partneritetit Europian. Ky dokument përmbledh në një dokument të vetëm masat e nevojshme për adresimin e angazhimeve të marra nga Shqipëria në kuadër të Procesit të Stabilizimit - Asociimit. Çdo institucion, ka detajuar në këtë Plan, të gjitha angazhimet që duhet të ndërmarri, në formën e Iniciativave Ligjore dhe Aktivitetëve Zbatuesë, me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja apo Dokumentat e tjerë të rëndësishëm. Ky Plan është një instrument që përcakton prioritetet sipas sektorëve dhe monitoron procesin e integritimit evropian. Në përputhje me MSA-në, Plani mbulon një periudhë 6 vjeçare, e cila është ndarë në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata sipas

kritereve të Partneritetit European.

Struktura e Planit është e njëjtë me atë të raporteve vjetore të Komisionit European dhe është i ndarë në tre kapituj kryesorë që kanë të bëjnë me gjendjen politike, gjendjen ekonomike dhe standardet europiane. Adoptimi progresiv i *acquis communautaire* në sistemin vendas gjatë periudhës së zbatimit të MSA do të sjellë rishikimin e strukturave ekzistuese dhe ngritjen e institucioneve të reja, reformimin e politikave ekzistuese duke i sjellë ato në përputhje me standardet e BE.

Për të bërë të mundur një programim më të mirë të asistencës së CARDS apo IPA, si dhe për të përfituar ndihmë nga donatorë të tjerë, Plani identifikon projektet dy ose shumë palëshe me një citim të titullit, buxhetit në dispozicion ose një përshkrim i shkurtër i përbërësve, aktiviteteve dhe statusit të zbatimit të tyre.

## KAPITULLI IV

### **Historiku i zgjerimit të BE-së dhe procesi i antarësimit të Shqipërisë**

Bashkimi Europian përbën një rend juridik autonom, i cili ka tipare si të një oranzate ndërkombëtare ashtu edhe të një konfederate shtetesh.. Ky evoluim është mbështetur në një sërë Traktatesh të nënshkruara nga vendet e BE, që nga ato të nënshkruara në Paris, Romë, Mastriht, Amsterdam dhe Nicë. Të drejtat dhe detyrimet e parashtruara në këto Traktate janë pasqyruar në politikat që ndjek Bashkimi Europian. Një ndër politikat më të rëndësishme që BE po ndjek që nga krijimi i tij është ajo e zgjerimit. Në fakt termi “zgjerim”, u përdor në fillim për katër valët e para të njëpasnjëshme me anëtarë të rinj që u bashkuan me Komunitetin Europian<sup>21</sup>. Gjashtë vendet themeluese<sup>22</sup>, sado që ishin në zemër të Europës nuk mund të shprehnin dimensionin e kësaj aspirote. Për këtë arsye që nga themelimi i strukturës së përbashkët, BE ka qenë i hapur për të pranuar anëtarë të rinj. Vendet e para që ju bashkuan gjashtë vendeve themeluese ishin: Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar. Këto shtete, bashkë me Norvegjinë, nënshkruan në 22 janar 1972, traktatet e aderimit në Komunitetin Europian dhe që nga 1 janari 1973 u bënë anëtarë të BE, duke e çuar numrin e anëtarëve në nëntë. Ndërsa Norvegjia mbeti jashtë, pasi qytetarët norvegjezë, nëpërmjet një referendumi, votuan kundër antarësimit. Pas antarësimit të këtyre tre vendeve, BE nënshkruan në 28 maj 1979 një traktat pranimi me Greqinë, e cila ju bashkua bllokut në 1 janar 1981.

Suksesi politik dhe ekonomik i këtij blloku, bëri që Spanja dhe Portugalia të aplikonin për tu bërë pjesë e tij dhe në 12 qershor 1985 ato nënshkruajnë traktatet e aderimit me Komunitetin Europian. Në 1 janar 1986, bashkë me Spanjën dhe Portugalinë, numri i vendeve anëtare të BE shkoi në 12. Zgjerimi do të vijonte më tej, kur pas nënshkrimit më 25 qershor 1994, të traktateve të aderimit me Austrinë, Finlandën, Norvegjinë dhe Suedinë, në 1 janar 1995, Austria, Finlanda dhe Suedia i bashkohen BE, duke lënë sërish jashtë Norvegjinë. Edhe këtë herë, qytetarët norvegjezë, votuan kundër antarësimit. Kjo valë e katërt e zgjerimit, bashkoi në një bllok të vetëm, të gjitha vendet perëndimore europiane.

Kjo në fakt, konsiderohej një sfidë edhe për vetë Bashkimin European, pasi një pjesë e madhe e tyre, kishin qenë pjesë e bllokut të Bashkimit Sovjetik. Disa prej shteteve anëtare vunë kushtin, që zgjerimi mund të ndodhë, vetëm nëse ky proces nuk do të kishtë pasoja negative, kryesisht për ekonomitë e tyre të përbashkëta. Për të larguar frikën që zgjerimi do të shoqërohej me dobësim, u vu kushti që “BE duhet të jetë e aftë të thithë anëtarë të rinj duke mos cënuar procesin e integritetit”.<sup>24</sup>

Pas negociatave dhe miratimit të tre Traktateve shumë të rëndësishme, Mاستrihti (1993), Amsterdami (1997) dhe Nisa (2000), të cilat hodhën bazat për reformatimin e strukturave dhe politikave të BE-së, në 13 dhjetor 2002, Këshilli European, ra dakord që 10 prej vendeve kandidate: Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Polonia, Lituania, Malta, Sllovenia dhe Sllovakia, mund ti bashkohen Bashkimit European në 1 maj 2004.

Rumania dhe Bullgaria pritet ti bashkohen në vitin 2007. Pas kësaj vale anëtarësimi, më e madhja e deritanishme, në 1 maj 2004, numri i shteteve anëtare të BE shkoi në 25. Tashmë Bashkimi European është një bllok me 27 shtete anëtare. Ndërkohë që BE është duke negociuar edhe me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, të cilët kanë aplikuar për tu anëtarësuar në BE.

#### **4.1 Prespektiva e Turqisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e zgjerimit**

Sipas nenit 49 të Traktatit të BE-së, çdo shtet european i cili respekton parimet themelore të lirisë, demokracisë, zotohet për respektimin e të drejtave të njeriut, lirive të tjera themelore dhe vendosjen e shtetit të së drejtës mund të aplikojë për tu anëtarësuar në Bashkimin European<sup>25</sup>. Zgjerimi i mëtejshëm i Bashkimit European do të ndodhë për ato shtete, të cilat do të plotësojnë tre Kriteret e Kopenhagenit: (a) respektimi i shtetit të së drejtës, (b) krijimin e një ekonomie tregu, të tillë që të mund ti bëjë ballë presioneve që vijnë nga konkurrenca e tregut të brendshëm dhe (c) përafrimi i legjislacionit të brendshëm me atë të BE dhe forcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e këtij legjislacioni.

Vendet të cilat, janë duke negociuar aktualisht me institucionet e BE-së dhe që synojnë anëtarësimin në BE janë Turqia dhe vendet e Ballkanit Perëndimor<sup>26</sup>. Në Këshillin European të Helsinkit të vitit 1999, u nënvizua se Turqia është një vend kandidat i destinuar për tju bashkuar BE-së, pas plotësimit të disa kriterëve të aplikuar edhe për vendet e tjera kandidate. Ky vendim mund të konsiderohet si një prej



vendimeve më të rëndësishme për Turqinë, pas një periudhe shumë të gjatë negociimi. Turqia ka aplikuar për tu anëtarësuar në Bashkimin Europian që në vitin 1987, por në vitin 1989 Këshilli dha një opinion negativ, duke e shtyrë për më tej negociimin me këtë vend. Pas monitorimit të zhvillimeve në Turqi, në 3 tetor 2005, u hap procesi i negociimit ndërmjet Turqisë dhe BE. Aktualisht, Turqia ka marrë statusin e vendit kandidat potencial dhe ndodhet në procesin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me kapitujt e legjislacionit europian.

#### **4.2 Kronologjia e marrëdhënieve me BE <sup>27</sup>**

Procesi i integritit i Shqipërisë në Bashkimin Europian (BE) është konsideruar si prioriteti më strategjik kombëtar, i cili udhëheq axhendën qeverisëse të vendit.

Në vitin 1992 u nënshkrua Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë dhe Shqipëria u bë e pranueshme për financim në kuadrin e programit të BE-së Phare. Në vitin 1997, Këshilli i Ministrave i BE-së krijoi kushtëzime politike dhe ekonomike për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe BE.

Në vitin 1999, BE propozoi Procesin e ri të Stabilizim Asociimit (PSA) për pesë vende të Evropës Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë. Që nga viti 1999 Shqipëria përfitoi nga Preferencat Autonome të Tregtisë me BE.

Në vitin 2000, qasja pa taksë në tregun e BE ishte dhënë për produktet nga Shqipëria. Në qershor 2000, gjatë Këshillit Evropian u shprehën se të gjitha vendet e SAP janë "kandidatë të mundshëm" për anëtarësimin në BE. Në nëntor të vitit 2000, në Samitin e Zagrebit, SAP u miratua zyrtarisht nga BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor (përfshirë Shqipërinë).

2001 ishte viti i parë i programit të ri CARDS i projektuar posaçërisht për vendet e SAP. Në qershor 2001, Komisioni rekomandoi ndërmarrjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (SAA) me Shqipërinë. Këshilli Evropian i Göteborgut (qershor 2001) ftoi Komisionin të paraqiste direktivat e negociatave për negociimin e një SAA.

Në tetor 2002 u miratuan direktivat për negociimin e një SAA me Shqipërinë më 31 janar 2003. Më 31 janar, Presidenti i Komisionit Prodi zyrtarisht fillon negociatat për një SAA midis BE dhe Shqipërisë.

Në Qershor 2003 në Samitin e Selanikut, PSA u konfirmua si politika e BE për Ballkanin Perëndimor dhe perspektiva e BE-së për këto vende u konfirmua (vendet pjesëmarrëse në

PSA filluan të ishin të pranueshëm për pranimin në BE dhe do të bashkoheshin me BE sapo ata do të bëhen gati).

Në dhjetor 2005, Këshilli mori vendimin mbi parimet e një Partneriteti Evropian të rishikuar për Shqipërinë. Më 12 qershor 2006, MSA u nënshkrua në Këshillin e Marrëdhënieve të Përgjithshme dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Luksemburg.

Më 9 nëntor 2006, Komisioni Evropian vendosi të fillojë negociatat për lehtësimin e vizave me Shqipërinë dhe më 13 prill 2007 u nënshkrua marrëveshja për lehtësimin e vizave në Zagreb. Komiteti i nënshkrimit të BE Franco Frattini u citua duke thënë se ky është hapi i parë drejt heqjes së plotë të kërkesave për viza dhe lëvizjes së lirë të shtetasve shqiptarë në BE.

Më 1 janar 2008 hyri në fuqi marrëveshja për lehtësimin e vizave dhe më 7 mars 2008, komisioneri i BE Franco Frattini hapi në Tiranë dialogun drejt liberalizimit të regjimit të vizave midis Shqipërisë dhe BE.

Më 14 janar 2009 u përfundua procesi i ratifikimit të MSA nga të gjitha shtetet anëtare dhe më 1 prill 2009 MSA hyri në fuqi. Më 28 prill 2009, Shqipëria aplikoi zyrtarisht për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Më 16 nëntor 2009, Këshilli i BE i kërkoi Komisionit Evropian të përgatisë një vlerësim mbi gatishmërinë e Shqipërisë për të filluar negociatat e pranimit. Komisioni parashtrroi pyetësorin për përgatitjen e pranimit në qeverinë shqiptare.

Më 14 prill 2010, Shqipëria paraqiti përgjigje në pyetësorin e Komisionit Evropian por statusi i kandidaturës nuk u dha nga BE në dhjetor 2010 për shkak të rradhës politike afatgjatë në vend.<sup>1</sup>

Më 27 maj 2010, Komisioni Evropian propozoi udhëtimin pa viza për Shqipërinë. Propozimi i miratuar do t'u mundësojë qytetarëve të Shqipërisë të udhëtojnë në vendet e Shengenit pa pasur nevojë për vizë afatshkurtër. Më 8 nëntor 2010 Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi udhëtimin pa viza në zonën Shengen për shtetasit shqiptarë. Më 15 dhjetor 2010 hyri në fuqi hyrja pa viza në zonën Shengen dhe më 10 tetor 2012 Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepej statusi i kandidatit të BE-së, në varësi të përfundimit të masave kyçe në fusha të caktuara.

Parlamenti në gusht të vitit 2012 hodhi poshtë një propozim për heqjen e imunitetit për anëtarët e parlamentit, ministrat dhe njerëzit në disa pozicione të tjera zyrtare. BE kërkoi që kjo të shfuqizohet së bashku me 11 çështje të tjera kryesore, kështu që statusi i kandidatit u

shty më tej. Megjithatë, në shtator 2012 u miratua njëzëri një amendament kushtetues i cili kufizoi imunitetin e parlamentarëve.

Raporti arriti në përfundimin se nëse Shqipëria arriti të mbajë një zgjedhje parlamentare të drejtë dhe demokratike në qershor 2013. Më 23 qershor 2013, Shqipëria zhvilloi një zgjedhje të përgjithshme, të cilësuar përgjithësisht si të lirë dhe të drejtë. Ambasadori i BE në Shqipëri tha më 17 korrik se Shqipëria kishte takuar shumë prej tyre këto kushte, dhe mund të jetë një kandidat zyrtar deri në dhjetor 2013.

Më 16 tetor 2013, Komisioni Evropian lëshoi raportet e saj vjetore për vendet anëtare të ardhshme, të cilat përfunduan se zgjedhjet në Shqipëri u mbajtën në një mënyrë "të rregullt" dhe se ishte bërë progres në plotësimin e kushteve të tjera; Si i tillë rekomandoi dhënien e statusit të vendit kandidat në Shqipëri. Më 5 dhjetor 2013, në një takim të deputetëve u rekomandua që "... Këshilli duhet të pranojë përparimin e bërë nga Shqipëria duke i dhënë statusin e kandidatit pa vonesa të panevojshme." Megjithatë, disa shtete, duke përfshirë Danimarkën dhe Hollandën, mbetën duke kundërshtuar dhënien e statusit të vendit kandidat në Shqipëri derisa të tregonte se përparimi i tij i fundit mund të ishte i qëndrueshëm. Si pasojë, Këshilli i Bashkimit Evropian, në mbledhjen e tij në dhjetor 2013, u pajtua që të shtyjë vendimin për statusin e kandidatit deri në qershor 2014.

Më 24 qershor 2014, nën Presidencën Greke të BE-së, Këshilli i Bashkimit Evropian ranë dakord të japin statusin e kandidatit të Shqipërisë, i cili u miratua disa ditë më vonë nga Këshilli Evropian. Kjo përkoj me 10 vjetorin e "Axhendës 2014", të propozuar nga qeveria greke në 2004, si pjesë e Samitit BE-Ballkani Perëndimor në Selanik, për të rritur integrimin e të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Në mars 2015, në takimin e pestë "Takimi i Dialogut të Nivelit të Lartë" midis Shqipërisë dhe BE, Komisioneri i BE për Zgjerimin (Johannes Hahn) njoftoi Shqipërinë për vendosjen e një date fillestare për negociatat e pranimit për të filluar ende të nevojshme që të plotësohen këto dy kushte:

- 1) Qeveria duhet të rihapë dialogun politik me opozitën parlamentare.
- 2) Shqipëria duhet të ofrojë reforma cilësore për të gjitha 5 fushat e identifikuar më herët, të cilat ende nuk janë plotësuar (administrata publike, sundimi i ligjit, korrupsioni, krimi i organizuar, të drejtat themelore.)

Ky qëndrim zyrtar, u mbështet plotësisht nga Parlamenti Evropian përmes miratimit të një rezolute të komentuar në prill 2015, i cili në thelb u pajtua me të gjitha konkluzionet e nxjerra nga raporti i Progresit të fundit të Komisionit 2014 për Shqipërinë.

Parlamenti shqiptar miratoi amendamentet kushtetuese mbi reformat e drejtësisë më 22 korrik 2016. Shqipëria shpresonte të hapte negociatat e anëtarësimit deri në dhjetor 2016. Komisioni rekomandoi fillimin e negociatave më 9 nëntor 2016. Megjithatë, më 26 nëntor, Gjermania njoftoi se do të vërë veton ndaj bisedimeve për pranimin deri në 2018.

Në fillim të vitit 2017, Parlamenti Evropian paralajmëroi krerët e qeverisë se zgjedhjet parlamentare në qershor duhet të jenë "të lira dhe të drejta" përpara se negociatat të fillojnë të pranojnë vendin në Bashkim. Në samitin e 24 Marsit 2020 u mor vendimi i hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

### **4.3 Sfidat e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian**

Procesi i Integrimit Evropian, krahas përfitimeve ka dhe një sërë kostosh për vendin. Me fjalë të tjera, për të arritur tek përfitimet Shqipërisë do t'i duhet të përballojë sfidën që vjen prej kostove të procesit të Integrimit. Janë disa sfidat me të cilat duhet të ndeshet kryesisht qeveria dhe shteti shqiptar.

#### **1. Forcimi i administratës publike**

Administrata publike ka rol thelbësor në procesin e Integrimit Evropian të vendit. Është administrata publike që ka detyrën të vërë në zbatim angazhimet që ndërmerret qeveria shqiptare në kuadër të këtij procesi. Problemet me të cilat është ndeshur administrata publike gjatë viteve të tranzicionit kanë qenë të shumta: ato kanë variuar nga rekrutimi i nëpunësve të

administratës mbi baza lidhjesh nepotike e politike, arbitrariteti i lëvizjeve dhe pushimeve nga vendi i punës, mungesa e praktikave të punës dhe logjistikës së nevojshme, tek trajnimet e pamjaftueshme, puna e dobët që kryhet nga strukturat monitoruese të punonjësve të administratës, pagat e ulëta dhe mungesa në përgjithësi e motivimit të nëpunësve civilë.

Kjo gjendje e administratës publike është vënë në dukje edhe nga Komisioni Evropian në raportet monitoruese për Shqipërinë. Në veçanti Komisioni Evropian është treguar mjaft skeptik në lidhje me aftësitë e administratës publike të Shqipërisë për të zbatuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Kjo ka qenë njëra prej arsyeve kryesore për shtyrjen

kaq të gjatë të nënshkrimit të MSA-së. Detyrimet e Shqipërisë të parashikuara në MSA do të shoqërohen me fonde të mëdha në kuadër të programeve të asistencës komunitare. Kjo do të thotë se sa më shumë të përparojë Shqipëria në procesin e Integritit, aq më e madhe do të jetë ndihma financiare e Komunitetit Evropian. Nga ana tjetër, duke qenë se fenomeni I korrupsionit nuk është një rast i veçuar në administratën publike shqiptare, por përkundrazi ndeshet shpesh dhe në përmasa të gjera, është e natyrshme që Brukseli nuk dëshiron që paratë e ardhura prej taksave të qytetarëve evropianë të pasurojnë në mënyrë të paligjshme disa njerëz në Shqipëri. Pa një administratë publike të aftë të kuptojë proceset integruese dhe me vullnetin e ndërjegjen e duhur profesionale, procesi i Integritit të Shqipërisë në BE nuk mund të përparojë.

## **2. Reforma fiskale**

Shqipëria është një vend në të cilin të ardhurat nga tarifatat doganore mbi produktet e importit zënë një përqindje shumë të lartë në buxhetin e shtetit krahasuar me shtetet anëtare të BE-së apo dhe me vende të tjera të rajonit të Ballkanit. Në Slloveni dhe Bullgari të ardhurat buxhetore nga doganat përbëjnë përkatësisht 0.6 dhe 0.7 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërkohë që në Shqipëri përbëjnë rreth 2 përqind. MSA parashikon reduktimin gradual të tarifave doganore mbi produktet e importit deri në heqjen e plotë të doganave në vitin e dhjetë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Kjo do të thotë që në buxhetin e shtetit do të hyjnë gjithnjë e më pak të ardhura nga doganat, deri sa ky kontribut të bëhet zero. Në rastin e Shqipërisë reforma fiskale është e vështirë. Thënë ndryshe, për shkak të strukturës së ekonomisë shqiptare, ajo do të ketë një kosto më të madhe. Vendi bosh që do të mbetet në arkën e shtetit nga heqja e të ardhurave doganore do të duhet të mbushet me taksa të tjera, jo vetëm për të kompesuar humbjen e këtij burimi të ardhurash, por më tepër për të arritur një konsolidim fiskal të vendit, për të rritur nivelet e investimeve publike dhe për të bërë të mundur zbatimin e strategjive kombëtare për zhvillimin ekonomik e social.

## **3. Ngritja e një ekonomie konkurruese tregu**

Angazhimet e Shqipërisë në kuadër të MSA-së, dhe veçanërisht angazhimi për të krijuar një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, bëjnë që fati i komunitetit të biznesit shqiptar të jetë i lidhur ngushtë me atë të ekonomisë së vendit. Deri tani kompanitë shqiptare nuk e kanë ndjerë shumë presionin e konkurrencës. Edhe hyrja në

fuqi e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit të Ballkanit, pavarësisht zhurmës mediatike, nuk sollli humbje të rënda për biznesin vendas. Kjo gjë nuk ndodhi, për arsyen e thjeshtë se volumi tregtar i Shqipërisë me këto vende është shumë i vogël.

#### **4. Përafrimi i legjislacionit**

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë evropian është detyrë parësore e Shqipërisë.

Rëndësia e përafrimit të legjislacionit shihet më tepër po të analizohet në kuadër të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në tregun evropian. Në mënyrë që produktet shqiptare të jenë konkurruese në tregun evropian, ato kanë nevojë të standardizohen dhe çertifikohen. Për standardizimin dhe çertifikimin e produkteve ka mijëra faqe të së drejtës evropiane, me të cilat duhet të përafrohen ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të shtetit shqiptar. Përafrimi i legjislacionit është thelbësor për zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe përfitimin nga hapësirat që lejojnë marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet Shqipërisë dhe KE-së.

#### **4.4 Kostot dhe përfitimet e Shqipërisë drejt integrimit evropian**

##### **Disa nga kostot e procesit që do të rëndojnë ekonominë vendase:**

Kostot e procesit të integrimit janë ndër çështjet parësore dhe shqetësuese me të cilat duhet të përballet vendi. Disa nga kostot me të rëndësishme për vëmendje mund të përmenden:

Kosto për përafrimin e politikave dhe legjislacionit me politikën dhe legjislacionin evropian – Me qëllim nxjerrjen e përfitimeve dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Shqipëria duhet së pari të përafrojë legjislacionin shqiptar me atë komunitar dhe së dyti nevojitet forcimi i kapaciteteve administrative të cilat do të zbatojnë këtë marrëveshje. Të dy këto procese kanë një kosto të madhe financiare.

· **Kostot për modernizimin e prodhimit dhe potencialeve industriale** – Kërkesa për produktet e BE në tregun shqiptar do të rritet si rezultat i çmimeve të ulëta të tyre dhe cilësisë së lartë që ato ofrojnë për konsumatorin. Pra importet shqiptare nga BE priten të rriten.

Ndërsa tregjet europiane do të kenë një kërkesë të ulët për një pjesë të produkteve shqiptare sa kohë që ato të mos plotësojnë kërkesat lidhur me cilësinë, teknologjinë e prodhimit, manaxhimin, etj. Për t'u bërë konkurrues, është e nevojshme të modernizohen proceset e prodhimit dhe të përmirësohen potencialet industriale: të gjitha këto kërkojnë kosto të mëdha.

- **Reduktime në prodhim dhe rritje te mundshme te papunësisë** – Përballimi i konkurrencës dhe pranimi i rregullave te BE-së, te cilat shmangin trajtimet preferenciale për përfituesit vendas në punë, mund të shfaqet një rënie në prodhim dhe rritje e papunësisë.
- **Kostot e programeve sociale për punonjësit te cilët humbin punen e tyre**

Qeveria duhet të zhvillojë një politikë aktive punësimi për të shmangur problemet akute të papunësisë. Një theks i vecantë duhet të vihet në marrjen e masave për ri trajnimin dhe ripunësimin e punëtorëve të prekur nga privatizimi/ristrukturimi i ndërmarrjeve shtetërore apo reduktimet në administratën publike, si dhe te gjitha masat mbështetëse për të papunët. Qeveria duhet të racionalizojë politikat sociale dhe të stabilizojë një kuadër të ri legjislativ për të mbrojtur të drejtat në punë. Nje prioritet të vecantë duhet të kenë pensionet dhe skemat e sigurimeve sociale me orientimin e sigurimit të nje mbrojtjeje më te mire sociale, vecanërisht për grupet me vulnerable te shoqërisë.

- **Kostot sektoriale** – Reforma e sektorëve të ndikuar nga konkurrenca e re, të tilla si kompani që nuk mund ta përballojnë këtë konkurrencë, kërkon mbështetje të mëdha financiare. Reforma në sektorin e shëndetësisë me qëllim ristrukturimin e kujdesit parësor shëndetësor dhe institucionet shëndetësore, reformimin e sistemit të financimit dhe të pagesës së shërbimeve, modernizimi i shpërndarjes së shërbimit së kujdesit shëndetësor dhe rritja e investimeve në pajisjet shëndetësore dhe trainimin e profesionistëve kërkojnë financime të mëdha. Sistemi shëndetësor përbën një tjetër sektor që do të zhvillohet me shumë për t'iu përshtatur sistemit Europian, si dhe nevojave të tregut të punës me çfarë ofron sistemi i edukimit dhe trajnimit.

Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar do të kërkojë më shume konsolidim, shkrirje apo mbyllje të institucioneve financiare në funksion të rritjes së besueshmërisë në sistemin bankar dhe tek depozituesit.

Subvencionet direkte në Shqipëri, kryesisht te dhëna ne sektorin e transportit dhe ate te bujqesise jane shume, shume te vogla ne krahasim me vendet e tjera në tranzicion. Më shumë financim do te jetë i nevojshëm qe të jepet.

**Rritje e deficitit tregtar** – Për shkak të cmimeve të ulta të mallrave të importit dhe cmimeve të larta të produkteve vendase, Shqipëria po përballon një deficit në rritje të bilancit tregtar. Ristrukturimi i ngadaltë dhe i pamjaftueshëm ka përbërë një barrierë në përshtatjen e prodhimit shqiptar me kërkesen ne vendet industriale. Kosto të larta do të duhen te përballohen për të ulur deficitin tregtar dhe nxitur konkurrencën e sektorëve dhe ndërmarrjeve shqiptare.

- **Vështirësi në bujqësi** –Kostot potenciale për të siguruar përputhshmeri të plote me terësinë e legjislacionit Europian, përfshirë edhe bujqësinë, do të jenë të larta. Shqipëria është duke u përballur me probleme të shumta në këtë sektor: infrastrukture e pazhvilluar institucionale dhe tregu, madhësia shumë e vogël e ndërmarrjeve, vështirësi në blerjen dhe dhënien me qira të tokës, sipërfaqe të tëra toke të pakultivuara apo të neglizhuara, nivel i ulët teknologjik, sistem jo transparent subvencionesh, etj.

Prandaj, shumë prodhues do të ndiejnë dyshim dhe ndoshta frikë lidhur me aftësinë e tyre për t'u përballur me produktet cilësore të BE-së, pra për ti konkurruar ato.

Me qëllim që të arrihen standartet e BE-së, Shqipërisë do të t'i duhet të modernizojë sektorin bujqësor, të përdorë makineri dhe teknika moderne, me shumë trajnime, dhe që të gjitha këto kërkojnë kosto të larta.

Shqipëria është një vend shumë i vogël, dhe si e tillë duhet të zhvillojë një ekonomi të hapur, të orientuar drejt eksportit me qëllim që aktivisht të konkurojë në tregjet e BE dhe ato ndërkombëtare.

Në periudhën afatshkurtër, efektet do të jenë të shumta, sepse industria vendase nuk është konkurrese sa duhet dhe eliminimi i tarifave bilaterale me BE-në mund të rezultojë në një rritje të importeve nga BE-ja, ndërsa eksportet nuk do të zhvillohen me të njëjtin ritëm. Gjithashtu, do të ketë kosto shtesë të përshtatjes me standartet e BE-së në shumë fusha/sectore.

### **Përfitimet ekonomike të procesit të integrimit**

- **Mirëqeverisje-** Me qëllim përshpejtimin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria duhet të forcojë shtetin ligjor dhe institucionet shtetërore, të sigurojë funksionimin e tyre në mënyrë efektive, të forcojë kapacitetet administrative, dhe të luftojë aktivitetet e paligjshme.



- **Pjesëmarrje në procesin e globalizimit dhe pranimin në tregjet botërore**— Në një botë të globalizuar, një rritje e kënaqshme e eksporteve është esenciale për një rritje të qëndrueshme afatgjatë për një vend të vogël si Shqipëria. Duke qenë një vend i vogël, me një treg të vogël, kapaciteti i Shqipërisë për të marrë pjesë në procesin e globalizimit, për të qenë konkurrese në tregun botëror do të rritet fuqishëm me anëtarësimin në BE.
- **Një akses i rritur dhe i sigurtë në tregun europian** —BE është partneri më i rëndësishëm tregtar i Shqipërisë, me importet 6 herë më të larta se eksportet. Heqja e barrierave tregtare ka një rëndësi të dukshme për Shqipërinë për të fituar akses në tregun europian dhe për të lehtësuar tregtinë.
- **Një perspektivë më e mirë për të bërë biznes** – Integrimi do të sjellë perspektivën e afërt për të marrë pjesë në një treg të vetëm, unik prej mbi 500 milion konsumatorë, gjë e cila ofron një perspektivë më të mirë për të bërë biznes. Në sajë të një kuadri të njejtë ligjor dhe standarteve të certifikuara në përputhje me ato të BE-së, do të jetë më e lehtë për të bërë biznes në të gjithë Europën.
- **Produktiviteti i rritur dhe kompani shqiptare konkurrese** – Rritja e produktivitetit është parakushti kryesor për rritje të eksporteve shqiptare në BE. Problemi më i madh i Shqipërisë gjatë viteve të tranzicionit ka qenë dhe është rënia e vazhdueshme e konkurrencës eksportuese dhe stacioni i eksporteve i kombinuar me një rritje po të vazhdueshme të importeve. Shumica e prodhimeve lokale shqiptare nuk përmbushin kërkesat lidhur me cilësinë dhe sistemi i marketingut të tyre është ende larg standarteve europiane. Integrimi ekonomik në BE do të shoqërohet me aftësi të firmave shqiptare që të operojnë në tregjet botërore dhe përmirësim të aftësive të tyre tregtuese.
- **Transferimi i teknologjisë dhe *knoë-hoë*** – Me integrimin europian, barrierat në transferimin e teknologjisë do të eliminohen dhe kjo do të rezultojë në rritjen e aksesit në sferën e inovacionit dhe kërkimeve për përmirësimin e produkteve. Si rezultat i këtij integrimi, Shqipëria do të marrë akses në teknologji dhe *knoë-hoë*, dhe do të jetë në gjendje të përmirësojë produktivitetin dhe konkurrencën në sektorët e saj.
- **Mirëqenia e konsumatorit** – Reduktimi i mundësive të firmave për të patur pozicionin monopol në vendosjen e cmimeve për shkak të cmimeve të ulta të mallrave të importit dhe segmentimit të tregut, do t'i japin konsumatorit një akses më të gjerë në zgjedhjen e mallrave dhe shërbimeve.

- **Perspektivë më e mirë për edukim dhe punësim** – EU ka ndihmuar tashmë vendet kandidatë potenciale si Shqipëria në përmirësimin e sistemit të edukimit, përmes programit CARDS dhe kohet e fundit përmes programeve TEMPUS. Qëllimi i të gjithë këtyre programeve është sigurimi i një niveli të lartë përmirësimi të edukimit dhe dhënia atij të një dimensionit Europian, për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkomëtar midis universiteteve, fuqizimin e lëvizshmërisë së studentëve dhe mësuesve dhe kontributin në përmirësimin e transparencës dhe njohjen akademike të kualifikimeve dhe studimeve të bëra në vend në të gjithë Bashkimin Evropian. Gjithashtu përfshihen grante për qindra studentë dhe mësues. Erasmus, programi më i njohur i të gjithë programeve të grupit Socrates, jo vetëm që synon shtimin e numrit të studentëve po edhe promovon lëvizshmërinë e tyre dhe për mësuesit mundëson shkëmbimin e eksperiencave, organizimin e kurseve të përbashkëta, apo pjesëmarrje në network-e tematike.
- **Reduktimi i kostove tregtare** – Eliminimi i tarifave dhe barrierave të tjera tregtare, si nga ana e BE, ashtu edhe nga Shqipëria, do të sjellë efekte positive në tregti. Reduktimi i kostove tregtare do të thjeshtojë procedurat për deklarimin e mallrave dhe do të lehtësojë tregtinë midis Shqipërisë dhe vendeve anëtare të Bashkimit Europian.
- **Lëvizje e Lirë e kapitaleve, mallrave dhe shërbimeve (Tregti e Lire), dhe njerëzve.** – Përveç adaptimit të standarteve të harmonizuara të certifikimit dhe testimit, do të lehtësohet tregtia, do të reduktohen barrierat tarifore dhe do të mundësohet lëvizja e lirë të njerëzve. Këta elementë do të përmirësojnë edhe bashkëpunimin rajonal.
- **Rritje e Investimeve të Huaja Direkte** – Për shkak të një niveli më të ulët të kursimeve vendase, kapitalet e huaja do të jenë vitale për modernizimin dhe ristrukturimin eficient të ekonomisë. Vetëm nëse risku politik është ulur dhe një ekonomi tregu efiçente është stabilizuar, mund të pritët një rritje e investimeve të huaja direkte në vend.
- **Përmirësimi i standarteve të mjedisit** – Anëtaresimi do të krijojë premisë për një politikë të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, ku elementët mjedisore do të jenë pjesë e politikave të zhvillimit të vendit. Duke adaptuar standartet mjedisore të BE-së, Shqipëria do të jetë në gjendje të mbrojë mjedisin e saj.
- **Rritje ekonomike dhe rritje e përgjithshme e standarteve të jetesës** – Si cdo vend anëtar që adapton politikat e BE-së për mbrojtjen e ambientit dhe luftën ndaj krimit të organizuar, drogës dhe imigracionit ilegal, si dhe politikat mbi çështjet sociale do

të ketë një cilësi më të lartë të jetesës për qytetarët. Në përgjithësi, integrimi në një ekonomi të hapur, të madhe, me afërsi gjeografike do të sjellë një rritje më të shpejtë ekonomike dhe një rritje të standarteve të jetesës.

Përfitime të tjera përfshijnë stabilitet cmimesh, stabilizim të ekonomisë eficiente të tregut, rritje dhe zhvillim të bazuar në avantazhet konkurruese dhe efektivitet të institucioneve. Pavarësisht nga këto, kostot e procesit të integritit janë ndër të parat, nga pikëpamja e kohës, me të cilat vendet që synojnë integrimin në BE do të përballen.

<sup>21</sup> Glosar për Integrimin Europian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Europian

<sup>22</sup> Gjermania, Franca, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu

<sup>23</sup> Qipro, Malta, Rumania, Bullgaria, Estonia, Hungaria, Polonia, Sllovakia, Republika Çeke, Sllovenia, Lituania dhe Letonia

<sup>24</sup> Bashkimi Europian, Një hyrje e shkurtër, fq 148

<sup>25</sup> Neni 49 I Traktatit të BE-së

<sup>26</sup> Shqipëria, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia dhe Bosnje Hercegovina

<sup>27</sup> Sekretariati për çështje europiane

## KAPITULLI V

### **Përafrimi i legjislacionit si kusht për anëtarësimin në BE**

Është një detyrim unik i anëtarësimit në Bashkimin Europian, për shtetet të cilat duan të aderojnë apo t'i bashkohen atij që të përafrojnë ligjet, procedurat dhe rregullat e tyre kombëtare në mënyrë që të japin efekt sa i përket organit të ligjit të BE-së, përfshirë dhe atë të Acquis Communautaire. Direktivat, rregulloret dhe vendimet e miratuara në bazë të Traktateve të ndryshme të BE-së janë të përfshira në Acquis Communautaire, të cilat Traktate së bashku përbëjnë ligjin parësor të BE-së.

### **Ekzistojnë tre elemente kryesore për përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së:**

Së pari, të miratohen ose ndryshohen ligjet, rregullat dhe procedurat kombëtare në mënyrë që kërkesat e ligjit përkatës të BE-së të përfshihen plotësisht në rendin ligjor kombëtar.

Ky proces njihet si Transpozim. Megjithëse, vendet kanë diskrecion të konsiderueshëm në zgjedhjen e mekanizmit më të përshtatshëm kombëtar për të reflektuar detyrimet mjedisore të Unionit, ky diskrecion është i kufizuar në disa aspekte nga parimet e përgjithshme të ligjit të Unionit. Në shumicën e rasteve do të jetë e nevojshme të miratohet legjislacioni kombëtar i miratuar nga Parlamenti ose në disa vende me Dekret Presidencial ose Qeveritar.

Së dyti, të sigurohen institucionet dhe buxhetet e nevojshme për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve (i njohur si 'Zbatimi' ose 'Zbatimi Praktik' i direktivës).

Së treti, të sigurohen kontrollet dhe gjobot e nevojshme për të siguruar që ligji po zbatohet plotësisht dhe në mënyrë të duhur.

Duke e patur parasysh që përafrimi është një proces tejet i vështirë, legjislacioni ekzistues i vendeve të cilat kanë aplikuar apo duan të jenë shtete anëtare është shumë i ndryshëm nga legjislacioni ekzistues i BE-së, prandaj standardet midis këtyre shteteve dhe BE-së ndryshojnë shumë, dhe rregullimi i mjedisit nga BE-ja mbulon një fushë më të gjerë çështjesh. Dështimi më i madh i shteteve aplikuese që ato të anëtarësohen në Union ndodh atëherë, kur ato kanë dështuar të përafrojnë siç duhet legjislacionin e tyre mjedisor, duke u përqendruar më shumë në çështje ekonomike. Prandaj, përafrimi sa më i suksesshëm është më se i nevojshëm që këto shtete të mund të bëhen pjesë e BE-së.

Në Bashkimin Evropian, koncepti i përafrimit të ligjit do të thotë procesi i harmonizimit të legjislacionit kombëtar me të drejtën e BE-së. Procesi i përafrimit përfshin metoda dhe teknika për të transpozuar legjislacionin e BE-së në të drejtën kombëtare, përfshirjen e saj në sistemet ligjore kombëtare dhe procesin e implementimit, e që individualisht, manifestohet përmes realizimit të të drejtave individuale ose supozimit të obligimeve konkrete.

Në pajtueshmëri me Nenin 4 të Traktatit të Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare të BE-së do të ndërmarrin çfarëdo mase të përshtatshme, në përgjithësi ose të veçantë, për të siguruar plotësimin e obligimeve që dalin nga Traktatet ose që rrjedhin nga aktet e institucioneve të BE-së. Gjithashtu, ato duhet të ndihmojnë edhe arritjen e detyrimeve të BE-së dhe të përmbahen nga

çfarëdo mase, që do të mund të rrezikonte arritjen e objektivave të BE-së.

Përafrimi i legjislacionit vendor me atë acquis të BE-së ka rëndësi të madhe pasi që është edhe njëri prej kushteve për shtetet të cilat kanë synim aderimin në BE.

### **5.1 Përafrimi i legjislacionit shqiptar me Acquis Communautaire**

Detyrimi i Republikës së Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit të saj me acquis të BE-së buron nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit BE-Shqipëri, e cila është nënshkruar më 12 qershor 2006 dhe ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009. Neni 70 i MSA-së parashikon se Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me acquis të BE-së. Ky përafrim ka filluar në datën e nënshkrimit të MSA-së dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementet e acquis të BE-së të parashikuara në këtë Marrëveshje brenda një periudhe tranzitore deri në 10 vjet, e ndarë në dy faza. Gjatë fazës së parë të periudhës tranzitore (e cila ka filluar me hyrjen në fuqi të MSA-së) përafrimi përqëndrohet në elementet thelbësore të acquis të Tregut të Brendshëm, kurse gjatë fazës së dytë Shqipëria do të përafrojë pjesët e mbetura të acquis.

Shqipëria ka ende shumë sfida për të arritur drejt rrugës së Integritimit Evropian ku më e përafërta prej tyre është çelja e negociatave për anëtarësimin në BE. Për Shqipërinë, hapja e negociatave kushtëzohet me ecurinë e mëtejshme të reformës në drejtësi, sidomos procesit të vetting-ut.

Në vendet të cilat janë në fazën e para-aderimit në BE, sikurse është Shqipëria, përputhja e të drejtës së brendshme me acquis-në e BE-së është një tjetër qëllim që duhet të mbahet parasysh.

Në tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepej statusi i vendit kandidat, me kusht plotësimin e masave kyçe që kishin të bënin me reformën në drejtësi, administratën publike, si dhe rishikimin e rregulloreve parlamentare.

Në qershor të vitit 2014, Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat dhe aktualisht është në pritje të hapjes së bisedimeve për anëtarësim. Vendimi për hapjen e bisedimeve për anëtarësim, merret atëherë kur BE-ja vlerëson se vendi kandidat ka plotësuar kriteret politike dhe ekonomike, pra, është një demokraci funksionale dhe një ekonomi e lirë e tregut.

Të gjitha fazat e procesit legjislativ, duke nisur me formulimin e politikave dhe përcaktimin e instrumentit rregullues (ligj) deri te hartimi i tekstit të aktit dhe miratimit të tij në Kuvend, janë pjesë e procesit të adresimit të kërkesave të acquis të BE-së në legjislacionin shqiptar, ndryshe procesi i përafrimit të legjislacionit. Në këtë proces përgjegjësinë kryesore për planifikimin dhe propozimin e nismave ligjore e ka qeveria. Por Kuvendi, si organi më i lartë ligjvënës në vend, luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e përafrimit të legjislacionin shqiptar me atë të BE-së, duke ushtruar kontrollin ligjor dhe politik të këtij procesi.

Procedura e shqyrtimit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në Kuvend përcaktohet në mënyrë të detajuar në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë dhe në ligjin nr.15/2015, datë 5.03.2015, "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian". Rregullorja e Kuvendit dhe ligji nr.15/2015 parashikojnë se projektligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian duhet të jenë të shoqëruara me relacionin shpjegues dhe tabelat e përputhshmërisë (instrumentet e përafrimit) dhe se organet e Kuvendit (Kryetari i Kuvendit dhe Komisioni për Integrimin Europian) mund të kthejnë te nismëtari projektligjet e depozituara në Kuvend kur konstatojnë mangësi në dokumentacionin që shoqëron projektligjin.

Projektligjet e propozuara Kuvendit që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian shqyrtohen nga Komisioni për Integrimin Europian, i cili ka në fushën e tij të përgjegjësisë përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian. Komisioni gjatë shqyrtimit të përputhshmërisë së projektligjit me acquis të BE-së analizon tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjin, duke krahasuar tekstin e projektligjit me pjesët e legjislacionit të Bashkimit Europian me të cilat projektligji është përafruar. Në

përfundim të shqyrtimit Komisioni për Integrimin European harton raportin përkatës, i cili përmban shkallën e përafrimit të projektligjit të propozuar me acquis të BE-së, si dhe amendamentet përkatëse për përmirësimin e tekstit të projektligjit, i cili i paraqitet Komisionit përgjegjës dhe seancës plenare. Sipas Rregullores së Kuvendit, raporti i Komisionit për Integrimin European është i detyrueshëm për t'u shqyrtuar nga komisioni përgjegjës para miratimit në tërësi të projektligjit. Në seancë plenare shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit me acquis të BE-së bëhet sipas procedurës së zakonshme ligjvënëse.

Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend i ofron Komisionit për Integrimin European dhe Kuvendit asistencën e nevojshme teknikoligjore në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së.

## **5.2. Përfshirja institucionale i acquis**

Nocioni i acquis-së së BE-së, shpesh i quajtur edhe *acquis communautaire*, i referohet korpusit ligjor të BE-së, i cili është i përbërë nga legjislacioni parësor (Traktatet) dhe dytësor (përfshirë për shembull Rregulloret dhe Direktivat) si dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë që i interpreton ato.

Legjislacioni parësor përbëhet nga traktatet, në veçanti Traktati i 1957 për Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE) dhe Traktati i 1992 i Bashkimit European (TBE), si dhe Traktatet e Aderimit të lidhura me vendet e reja anëtare. Traktatet përbejnë bazën politike dhe ligjore për të gjitha vendimet e institucioneve të BE-së dhe bëhen pjesë e legjislacionit kombëtar sapo një shtet bëhet anëtar i BE-së. Ato nuk kanë nevojë për përafrim për t'u bërë pjesë e legjislacionit kombëtar. Marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Komunitetet Europiane, të tilla si Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me Shqipërinë, përbëjnë gjithashtu pjesë integrale të legjislacionit parësor.

Legjislacioni dytësor i miratuar nga institucionet e BE-së përfshin, krahas të tjerave, Rregulloret, Direktivat, Vendimet, Rekomandimet dhe Opinionet. Secili nga këto akte ligjore ka karakteristikat e veta dhe u nënshtrohet rregullave të ndryshme për sa i takon përafrimit në sistemin kombëtar ligjor.

***Rregulloret*** kanë zbatim të përgjithshëm.

Ato janë të detyrueshme në tërësinë e tyre dhe janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare.

- Rregulloret zbatohen si për shtetet anëtare edhe për personat fizikë dhe juridikë.
- Ato përbëjnë instrumentet bazë për unifikimin e legjislacionit në të gjithë vendet anëtare.
- Përpara anëtarësimit të një shteti në BE ato nuk janë drejtpërdrejtë të zbatueshme, por duhen përafuar.
- Pas anëtarësimit, Rregulloret janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin ligjor të shteteve anëtare, çka do të thotë se parlamenteve të vendeve anëtare nuk u lejohet më t'i përafrojnë ato. Në raste të veçanta një shteti anëtar mund t'i duhet të adoptojë legjislacion për ta bërë të zbatueshme në praktikë një Rregullore (për shembull kur legjislacioni është i nevojshëm për ngritjen e një autoriteti kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen dhe detyra të tjera në çështjen specifike të mbuluar nga Rregullorja përkatëse).
- Dispozitat e tyre mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë në qoftë se ato janë formuluar me qartësi, të pakushtëzuara dhe mbartin të drejta dhe detyrime për ata të cilëve iu adresohet.

**Direktivat** janë detyruese për shtetet anëtare të cilave ato u adresohen për rezultatin që duhet të arrihet, por mënyra e veprimit dhe çështjet që lidhen më të u lihen autoriteteve kombëtare.

- Direktivat iu adresohen shteteve anëtare dhe pasi të jenë përafuar në të drejtën e brendshme iu adresohen edhe personave fizikë dhe juridikë.
- Ato kërkojnë gjithmonë përafrim (referenca e drejtpërdrejtë tek to nuk siguron përputhje me to nëse përmbajtja nuk është përafuar siç duhet).
- Dispozitat e tyre mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë ndaj personave fizikë dhe juridikë kur shteti anëtar ka dështuar të përafrojë Direktivën në mënyrën dhe kohën e duhur si dhe kur dispozitat e tyre janë të qarta, të pakushtëzuara dhe mbartin të drejta dhe detyrime për personat fizikë dhe juridikë. Direktivat nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë në mënyrë horizontale, d.m.th., ato nuk mund të përdoren përpara një gjykate kombëtare në procedime ndërmjet personave fizikë dhe/ose juridikë.

**Vendimet** janë detyruese në tërësinë e tyre. Vendimet të cilat specifikojnë ata të cilëve u adresohen janë detyruese vetëm për ata . Ato janë akte ligjore në të cilat të adresuarit janë përcaktuar në mënyrë të veçantë (një shtet, një numër shtetesh, persona fizikë, persona



juridikë). Ato janë drejtpërdrejtë të zbatueshme përveç rasteve kur përmbajtja e dispozitave të tyre kërkon miratimin e ligjit të brendshëm për zbatimin e tyre.

*Rekomandimet dhe opinionet* nuk kanë fuqi detyruese, por mund të shërbejnë si udhëzues të rëndësishëm. Si të tilla, ato mund të konsiderohen si “ligj i butë”.

### 5.3 Vlerësimi i përputhshmërisë

Cdo projekt ligj duhet të shoqërohet me një memorandum shpjegues që shpjegon dispozitat e tij me gjuhë të thjeshtë dhe joteknike. Ai gjithashtu duhet të tregojë përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së. Vlerësimi i përputhshmërisë së një mase të propozuar me *acquis*, është një proces me dy hapa.

**Se pari**, Ministria propozon masën legjislative, duhet të analizojë dhe të bëjë vlerësimin e saj të përputhshmërisë me *acquis* dhe ta tregojë këtë në memorandumin shpjegues që shoqëron projektin ligji.

**Së dyti**, Ministria e Integritimit certifikon përputhshmërinë. Të gjitha propozimet legjislative i paraqiten Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të përgjegjësisë parësore të Ministrisë së Drejtësisë për testimin e cilësisë së legjislacionit, përfshi testimin e legjislacionit sipas të drejtës evropiane. Ministria e linjës që harton Modelin e Raportit dhe Tabelën e Përputhshmërisë së projekt aktit ligjor, duhet të përfshijë informacionet e mëposhtme gjatë procedurës legjislative të mëposhtme:

1. Evidentimin e institucionit përgjegjës dhe bashkërendues
2. Statusin e aktit të propozuar në Rendin Hierarkik Legjislativ
3. Raportin e Projekt Aktit Ligjor përfshi objektivat e propozimit, një pershkrim të hapave kryesore për përgatitjen, shkallën e synuar të përputhshmërisë me *acquis*, arsyet pse projekt akti ligjor përputhet pjesërisht ose aspak, si dhe hapat e tjerë.
4. Një pershkrim të veprimeve Zbatuese, ku duhet të përfshihet legjislacioni dytësor për t’u miratuar si legjislacioni zbatues dhe veprimet jolegjislative, përfshi forcimin e kapaciteteve administrative, ngritjen e strukturave zbatuese, kostot financiare dhe sociale.

5. Rishikimin e cilesisë së legjislacionit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë
6. Konfirmimin nga ana e Ministrisë së Integritit
7. Konfirmimin nga ana e Kryeministrisë
8. Miratimin nga ana e Kuvendit

### **Udhëzimet që duhet të respektojmë për përafrimin e teksteve të ligjeve shqiptare**

**Së pari**, duhet të respektojmë parimet themelore dhe të përgjithshme të hartimit të ligjeve. Një prej këtyre parimeve është se legjislacioni duhet të jetë konsistent, koherent dhe i qartë. Këto kerkesa përmbushen më së miri kur përdoren teknika uniforme hartimi të cilat japin udhëzime të qarta, konsistente dhe të parashikueshme për strukturën dhe shprehjen e legjislacionit.

EURALIUS<sup>32</sup> ka përpiluar për Shqipërinë këto udhëzime për legjislacionin. Sipas të drejtës mbi bazën e precedenteve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, legjislacioni Komunitar duhet të jetë i qartë dhe i parashikueshëm për të gjithë ata që janë objekt i tij.

**Se dyti** Tabela e Perputhshmerise duhet të plotësohet me referime nga dispozitat e legjislacionit parësor dhe dytësor të Komunitetit Evropian, për aq sa është e aplikueshme. Pastaj duhet bërë një vlerësim nga ministrinë e linjës dhe Ministria e Integritit më pas, për perputhshmërinë e teksteve shqipëtare me legjislacionin e KE-se.

**Së treti**, mund të rezultojë e dobishme që të jepet përgjigje katër pyetjeve të mëposhtme:

#### **1. Cfarë duhet të ndryshohet në legjislacionin e brendshëm?**

a) Është e nevojshme të përcaktohet nëse qëllimi i ligjit të brendshëm korrespondon me atë të direktivës. Qëllimi i rishikimit të legjislacionit të brendshëm ekzistues, është së pari të identifikohen dispozitat që janë specifikuara të nevojshme për t'i shërbyer objektivave kombëtare dhe të shitet nëse duhen ndryshuar/amenduar.

b) Dispozitat kryesore operationale të direktivës duhet të krahasohen me legjislacionin e brendshëm ekzistues. Kur është e nevojshme, duhen hartuar amendimet e përshtatshme. Kjo mund të tingëllojë e lehtë, por nuk është ashtu. Traditat e ndryshme ligjore, teknikat ligjore hartuese si dhe praktikat e ndryshme gjyqësore dhe administrative, e bëjnë vlerësimin krahasues tepër të vështirë.

c) Duhet të identifkohen pikat ku direktiva i lejon ligjvënësit hapësirë për zgjedhje. Shembull tipik janë direktivat që përcaktojnë harmonizimin minimal apo opsional. Gjithashtu, në shumë direktiva ka mundësi për përjashtime. Direktivat shpesh i lejojnë ligjit të brendshëm që në situata të caktuara të zgjedhë rregulla më pak strikte. Në disa shtete ekzistojnë udhëzime të përgjithshme për thjeshtimin e procesit të legjislacionit, me qëllim zvogëlimin e burokracisë.

d) Duhet të identifkohen dispozitat administrative predominuese. Direktiva kërkon një strukturë administrative në gjendje që të marrë vendime të caktuara dhe të kryejë funksione të caktuara kontrolli. Këto institucione, sipas Gjykatës së Drejtesisë, duhet të jenë te afta të marrin vendime të shpejta dhe të drejta në mënyrë që “effect utile” i së drejtës së KE-së dhe shteti i së drejtës të aplikohen qartë.

## **2. A mund të funksionojnë rregullat në bazë të kuadreve institucionale ekzistuese?**

Cështja institucionale bëhet e vështirë kur është fjala për legjislacion terësisht të ri. Por edhe kur kuadret institucionale ekzistojnë, percaktimi i detyrave të reja dhe vlerësimi i nevojave të ardhshme për burime shtesë, mund të bëhet i vështirë. Burimet në formën e trajnimit, komunikimit elektronik dhe pajisjeve moderne, janë elementë të nevojshëm të forcimit institucional. Në fakt, koncepti i një kulture të re administrative do të jetë element i rëndësishëm në të gjitha fuqizimet institucionale. Pikërisht këtu reforma administrative do të luajë rol të vecantë.

## **3) Arsyet e devijimit nga direktiva (politike, praktike).**

Mund të ketë raste kur arsyet praktike justifikojnë derogimin nga acquis. Në raste të tilla, duhet të identifkohet së pari pikat se ku derogimet janë të nevojshme qoftë për arsye praktike apo për arsye interesi kombëtar, p.sh. kur i jepet industrisë njëfarë periudhe kohore për t’u pershtatur me normat e BE-së. Në shumicën e këtyre rasteve, është e mundur që të planifikohet një qasje graduale me zhvillimin legjislativ në etapa, deri në zbatimin e plotë të acquis. Vëmëndja i duhet kushtuar interesave shqiptare. Në fund, duhet të mbahet parasysh se të gjitha ndryshimet në legjislacion i shkaktojnë kosto industrisë.

## **4) Identifikimi i problemeve të terminologjisë.**

**Së katërti**, Vëmëndje e vecantë i duhet kushtuar zbatimit praktik ne terren të legjislacionit; kjo duhet të përmendet qartë në Tabelën e Përputhshmërisë. Shqipëria është e detyruar të harmonizojë kuadrin e brendshëm normative me acquis dhe ta zbatoje si duhet atw<sup>33</sup>.

Në vlerësimin e zbatimit në praktikë, të mëposhtmet janë të rëndësishme në cdo rast:

- Një rregullim ligjor duhet të ketë sa më pak hapësirë për mosmarreveshje për interpretimin
- Dispozitat e jashtëzakonshme duhet të jenë sa më minimale
- Ku është e mundur, rregullat duhet të vendosen për situata që janë te dukshme ose që mund të gjykohen subjektivisht
- Rregullimet ligjore duhet të jenë praktike si për ata që janë subjekt i tyre, ashtu edhe për ata që janë përgjegjës për zbatimin e tyre në praktikë

#### **5.4 Manuali i hartimit të ligjeve**

Është e rëndësishme të theksojmë se arritjet e realizuara nga vendi ynë gjatë procesit të integritit europian janë të shumta. Flitet për përmirësime të kushteve të jetesës, për ulje të nivelit të papunësisë, përpërmirësim të nevojave jetësore, shoqërore, shëndetësore, arsimore të popullatës dhe realizime të tjera, të cilat për hir të së vërtetës, në asnjë rast, nuk do të ishin të mundura pa mbështetjen e gjerë të qytetarëve në vend drejt integritit europian.

Për t'i realizuar sa më mirë dhe në një kohë sa më të shkurtër të gjitha kërkesat dhe kriteret e anëtarësimit në gjirin europian, vendi ynë është vazhdimisht në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe përfaqësuesit e Bashkimit Europian. Ne jemi në një rrugëtim kompleks të ndjekjes së rekomandimeve dhe direktave që na drejtohen nga BE-ja. Rëndësia madhore qëndron kryesisht te synimet apo objektivat që duhen arritur, duke përmendur se është esenciale që opinioni i Komisionit Europian duhet të përbëjë programin e punës për çdo institucion në Republikën e Shqipërisë dhe duhet të përkthehet në objektiva konkrete dhe të prekshëm për përmirësimin e punës dhe performancës së çdo institucioni, për të sjellë në një stad të ri rrugën e zhvillimit dhe të integritit europian të vendit.<sup>34</sup>

**Ndër më kryesoret citojmë:**

- Intensifikimin e përpjekjeve legislative,buxhetore,administrative dhe institucionale,si një prioritet strategjik,për të fituar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë,nëpërmjet një drejtësie të pavarur,transparente,të përgjegjshme dhe efikase.Strategjia e reformës në drejtësi të përfundojë në një afat sa më të shkurtër dhe të shërbejë si baza solide e konsolidimit dhe harmonizimit të përpjekjeve të përbashkëta,për të mundur një drejtësi të standardeve europiane në Shqipëri;<sup>35</sup>
- Lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit,duke implementuar me saktësi dhe profesionalizëm bazën e re legislative në këtë fushë dhe dukerritur bashkëpunimin polici–prokurori gjyqësor,për të përmbushur këtë objektiv të përbashkët dhe themelor për një shoqëri demokratike;
- Konsolidimin e një administrate civile profesionale,të aftë të përballojë zhvillimet e vendit dhe të konsolidojë rolin e saj si një aset i çmuar i organizimit shtetëror të Shqipërisë;
- Zbatimin në të drejtën e brendshme,në kuptimin legjislativ të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut me palë Republikën e Shqipërisë,por edhe në përgjithësi jurisprudencën e kësaj Gjykate për të drejtat e pronësisë;
- Marrjen e masave konkrete dhe të gjithanshme, nga çdo aktor dhe autoritet,për mbrojtjen e duhur të të drejtave dhe lirive të njeriut, përfshirë trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve,të grave,të të miturve,luftën efektiv edhe më cilësore për dhunën në familje,me theks të veçantë në parandalimin e saj,si dhe zbatimin e plotë të legjislacionit të detajuar për antidiskriminimin.<sup>36</sup>

Rol të rëndësishëm në proces, përveç faktorëve vendas dhe atyre europianë, kanë luajtur dhe një sërë aktesh,të cilat janë produkt i punës së përbashkët dhe konsultimeve midis aktorëve kryesorë.

Manuali i Hartimit të Ligjeve është një akt i një rëndësie të veçantë,dokument i cili është punuar nën vëmendjen e veçantë të Misionit EURALIUS.<sup>37</sup>

Padiskutim,që është familjare tashmë për të gjithë ne,rëndësia e rregullave të shkruara përpara se ato të mund të aplikohen në përditshmëri.

Ashtu si dhe rezulton nga praktika,dhe me shumë të drejtë citohet në këtë manual,një legjislacioni hartuar keq pakëson sigurinë dhe stabilitetin ligjor dhe jo vetëm kaq,por nuk mund të arrijë synimin për të cilin ky legjislacion është miratuar.

Në praktikë po ashtu,është shumë e vështirë që një legjislacion jo i hartuar në mënyrë të qartë,në gjuhë të kuptueshme,i cili lë vend për interpretime të shumta në parashikimin e

situatave të caktuara,të gjejë zbatim pavarësisht dëshirës së mirë të institucioneve dhe vetë qytetarëve.

Mangësitë në formulimin e rregullave të shkruara jo vetem që pengojnë ndjeshëm respektimin e këtyre rregullave,por edhe vënë në rrezik të madh një prej objektivave shumë të synuar nga vendi ynë,parimin e shtetit të së drejtës.

Manuali edhe pse është përpiluar në vitin 2010 <sup>38</sup>, paraqet rëndësi aktuale,duke qenë se vazhdon të merret për bazë gjatë hartimit dhe teknikës ligjore të draftimit dhe përpilimit të akteve të reja ligjore dhe nënligjore.

***Ky dokument është formalizuar në 4 kapituj të rëndësishëm:***

- I. Parimet e përgjithshme të procesit legjislativ;
- II. Procedura legjislative;
- III. Teknika e hartimit të ligjeve;
- IV. Implikimet e legjislacionit ndërkombëtar dhe të Bashkimit European në hartimin e ligjeve.

Ne e trajtojmë të drejtën që aplikohet në vendin tonë si unike;si një e tërë.

E drejta ndërkombëtare bëhet pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe gjen zbatim:të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet nxjerrjes së akteve të metejshme,në varësi të traktatit apo marrëveshjes që e parashikon atë.

Gjithsesi,ashtu si dhe është parashikuar në Kushtetutën tonë dhe në ligje të ndryshme,e drejta ndërkombëtare e ratifikuar nga vendi ynë zë një vend të rëndësishëm në hierarkinë e akteve normative në fuqi,që rregullojnë marrëdhëniet në vend,aq sa edhe në rast konflikti të kësaj të fundit me legjislacionin e brendshëm,e drejta ndërkombëtare ka përparësi.

Parimi i përgjithshëm i epërsisë së të drejtës ndërkombëtare e ka origjinën në bazë të Nenit 27 të Konventës së Vjenës,të vitit1969,mbi të Drejtën e Traktateve <sup>39</sup>,ku shtetet palë të Konventës nuk mund të bazohen në dispozitat e legjislacionit të tyre të brendshëm për të justifikuar mos zbatimin e dispozitave të një traktati ndërkombëtar.Ky status i veçantë,që e drejta ndërkombëtare gëzon në legjislacionin e aplikuar në vendin tonë,duket më së miri në një rast konkret,siç është rasti i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kushtetuta<sup>40</sup> i jep vetë kësaj konvente një rëndësi aq të madhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut,sa barazohet me rëndësinë e vetë Kushtetutës,kur parashikohet se kufizimet e të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Pikërisht, në bazë të të ashtu quajturave instrumente të përafrimit, manuali bën një prezantim edhe të niveleve të ndryshme të përafrimit:

**a)** “Plotësisht i përputhshëm” – projekt-akti normativ është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis-së dhe është në përputhje me parimet që rrjedhin nga këto dispozita;

**b)** “Pjesërisht i përputhshëm” – projekt-akti normativ është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me parimet kryesore të burimeve parësore dhe dytësore të Acquis-së, por jo me të gjitha;

**c)** “I papërputhshëm” – projekt akti normativ bie në kundërshtim me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis-së dhe nuk përputhet me parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave;

**d)** “I pazbatueshëm” – nuk ekziston asnjë dispozitë e burimeve parësore dhe dytësore e Acquis, e cila mund të krahasohet me projekt-aktin normativ, për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë së tij.<sup>42</sup>

Manuali referon në parimet bazë të cilat duhet të merren parasysh gjatë procesit të përafrimit të legjislacionit si psh.: parimet e sistemit kombëtar dhe parimet bazë ligjore dhe administrative të BE-së, që përfshijnë sundimin e së drejtës, qeverisjen e mirë, sigurinë ligjore dhe transparencën.

Në qoftë se baza ligjore përbëhet nga disa akte, atëherë studiohen hollësisht të gjitha këto rregullime. Paralelisht, studiohet parashikimi që bëhet për çështjen konkrete nga aktet ligjore të BE-së.

Në rast se ka parashikim dhe rregullim në legjislacionin vendas, atëherë menjëherë bëhet krahasimi përkatës midis parashikimeve të këtyre “dy legjislacioneve” dhe mbetet për t’u përshtatur dhe modifikuar e amenduar hapësira ligjore respektive në ligjin shqiptar.

28 Kuvendi i Shqipërisë

29 Neni 68, Rregullorja e Kuvendit

30 Neni 4, Ligji Zela i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dt. 08.07.2004

31 Neni 7, po aty

32 Misioni i Asistencës Evropiane për Sistemin Gjyqësor Shqiptar

33 Nw bazw tw Marrwveshjes sw Stabilizim Asocimit

34 [http://www.parlament.al/Rezolute\\_Per\\_integrimin\\_europian\\_te\\_Shqiperise\\_11650\\_1.php](http://www.parlament.al/Rezolute_Per_integrimin_europian_te_Shqiperise_11650_1.php)

35 Po aty.

36 [www.integrimi.gov.al](http://www.integrimi.gov.al)

37 Misioni Europian iAsistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë ;[www.drejtesia.gov.al](http://www.drejtesia.gov.al).

38 Faqe interneti:[www.euralius.eu](http://www.euralius.eu)

39 [www.europa.eu](http://www.europa.eu)

40 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

41 Përfshirë,psh,rregulloret dhe direktivat.

42 [www.integrimi.gov.al](http://www.integrimi.gov.al); Shih edhe: [www.parlament.al](http://www.parlament.al).

## 6.1 Konkluzione

Shqipëria, që me njohjen si një vend kandidat potencial në samitin e Zagrebit në 24 nëntor të vitit 2000, ka bërë një rrugëtim të gjatë drejt integrimit në Bashkimin Europian. Mbyllja e negociatave dhe nënshkrimi i Marrëveshjes të Stabilizim Asociimit (MSA), të nisura në 31 janar 2003, midis Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Europian dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian nga ana tjetër në Qershor 2006, shënon fillimin e një epoke të re për zhvillimin e politikave institucionale, ligjore, ekonomike dhe sociale të Shqipërisë, me qëllim harmonizimin e tyre me standardet europiane. Nënshkrimi i MSA-së përveç detyrimeve në planin politik, ligjor, ekonomik dhe institucional për Shqipërinë do të shoqërohet edhe me një kuadër të ri të marrëdhënieve BE-Shqipëri, duke shënuar stadin më të avancuar të kësaj marrëdhënieje. Procesi i integrimit duhet kuptuar si një proces që ndryshon hap pas hapi, ku progresi i arritur në çdo hap do të mundësojë afrimin gjithnjë e më tepër me kriteret dhe standardet e kërkuara prej BE-së.

Në kuadrin e punëve të brendshme është një pikë shumë e rëndësishme bashkpunimi ndërmjet forcave të policisë dhe ruajtjes së rendit të vendeve anëtare, nëpërmjet eksperiencave të përbashkëta, për luftën kunder krimit të organizuar dhe trafikëve.



Marreveshja e Stabilizim Asocimit, ka ndikuar në një frymë të re në bashkëpunimin ndërveprues mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera europiane.

Në kuadrin e integritit dhe të përafrimit të Shqipërisë me strukturat europiane, pika themelore qëndron në nevojën e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme mes Shqipërisë dhe BE-së. Në fushën e drejtësisë është i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet administradave të drejtësisë të vendeve anëtare, përmes formave dhe kontakteve permanente me legjislacionet përkatëse dhe ndryshimet e herë pas herëshme që mund të pësojnë ato.

Me nënshkrimin e MSA-së Shqipëria ka pësuar progres në institucionet e saja të drejtësisë, duke filluar që nga përmiresimet e vazhdueshme të legjislacionit, duke e përshtatur dhe përafruar atë me vendet e tjera anëtare, si dhe në të gjitha fushat e tjera social-ekonomike, të cilat prodhojnë zhvillim dhe progress.

### **Rekomandime për të ardhmen**

Që prej fillimit të procesit të anëtarësimit Shqipëria ka bërë hapa përpara për përmbushjen e secilit prej tyre, por nga ana tjetër një sërë fushash kyçe mbeten ende për tu përmbushur, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me kriteret politike. Gjithashtu Shqipëria duhet:

1. Të forcojë zbatimin e ligjit dhe të ndërmarrë reforma në drejtësi
2. Të zbatojë në mënyrë efektive strategjitë e qeverisë për antikorrupsionin
3. Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar
4. Të ndërmarrë hapa konkrete në drejtim të forcimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut
5. Të përforcohet bashkëpunimi rajonal
6. Të sigurojë mbajtjen e zgjedhjeve në përputhje me standartet ndërkombëtare

7. Të ndërmarrë hapa konkrete në përmbushjen e reformës në administratën publike duke përfshirë miratimin e amendamenteve në ligjin për shërbimin civil dhe të forcojë shërbimin civil duke u bazuar në profesionalizëm dhe në depolitizimin e administratës.

## **Bibliografia**

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve Anëtare nga njëra anë dhe Shqipëria nga ana tjetër.

<https://eksplorobe.com/procesi-i-stabilizim-asocimit/>

[https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Marr%C3%ABveshja\\_e\\_Stabilizim\\_Asociimit#Ecuria\\_e\\_ratifikimit\\_t%C3%AB\\_MSA-s%C3%AB](https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Marr%C3%ABveshja_e_Stabilizim_Asociimit#Ecuria_e_ratifikimit_t%C3%AB_MSA-s%C3%AB)

Bashkimi Evropian, 2009

<https://sq.shops-net.com/265794/1/kriteret-e-kopenhages.html>

<http://integrimi-ne-be.punetjashtme.gov.al/>

PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2016 – 2020

Partneriteti Evropian

Glosar për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian

Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Integritimit

Sekretariati për çështje evropiane

Eu Policy Hub Communicating Europe

Kuvendi i Shqipërisë

Manuali i EURALIUS (Misioni i Asistencës Evropiane për Sistemin Gjyqësor Shqiptar)

[www.kryeministria.gov.al](http://www.kryeministria.gov.al)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

[http://www.parlament.al/Rezolute\\_Per\\_integrimin\\_europian\\_te\\_Shqiperise\\_11650\\_1.php](http://www.parlament.al/Rezolute_Per_integrimin_europian_te_Shqiperise_11650_1.php)

